Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës
Tužilački Savet Kosova
Kosovo Prosecutorial Council

Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo

Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit
Državni Tužilac / State Prosecutor

# PLANI STRATEGJIK I SISTEMIT PROKURORIAL

## 2019 - 2021

Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës
Tužilački Savet Kosova
Kosovo Prosecutorial Council

Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo

Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit
Državni Tužilac / State Prosecutor

# PLANI STRATEGJIK I SISTEMIT PROKURORIAL

# 2019 - 2021

Prishtinë, shkurt 2019

**Tabela e përmbajtjes**

Hyrje....9

KAPITULLI I....11
1. Struktura institucionale....11
2. Zhvillimi institucional....13
1 Ndikimi i faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm për zbatimin e Planit strategjik 2019-2021....15

KAPITULLI II....21
1. Misioni....21
2. Vizioni....21
3. Vlerat....21
4. Supozimet....21

KAPITULLI III....23
1. Qëllimet dhe shtyllat strategjike....23
I. Shtylla I: Fuqizimi i efikasitetit dhe efektivitetit të administrimit të sistemit prokurorial....23
Objektivat specifike....25
1. Fuqizimi i kornizës ligjore dhe strukturës organizative të sistemit prokurorial....25
2. Avancimi i statusit dhe rolit të prokurorëve dhe personelit administrativ....26
3. Llogaridhënia sistematike dhe kontrolli permanent i punës së prokurorëve....27
4. Transparenca dhe komunikimi publik....28
5. Sigurimi i infrastrukturës fizike adekuate....30
6. Bashkëpunimi me institucionet vendore, i mbështetur në respekt reciprok....30
7. Bashkëpunimi me partnerë ndërkombëtarë dhe donatorë....31
8. Teknologjia informative dhe menaxhimi i të dhënave....33
9. Avancimi i rolit institucional në proceset buxhetore dhe financiare....34
10. Trajtimi i rasteve të bartura....35
II. Shtylla II: Fuqizimi i kapaciteteve institucionale dhe profesionale përmes përmirësimit të integritetit, llogaridhënies dhe transparencës të së sistemit prokurorial....35
Objektivat specifike....37
1. Fuqizimi i integritetit të prokurorëve....37
1. Avancimi i sistemit për vlerësimin e performancës së prokurorëve....38
2. Fuqizimi i mëtejmë i sistemit të rekrutimit të prokurorëve....38
3. Avancimi i sistemit të zhvillimit të karrierës....39
4. Reformimi i sistemit të disiplinimit....40

5. Ngritja e kapaciteteve profesionale dhe shkathtësive praktike të prokurorëve dhe personelit që reflekton aplikimin e praktikave më të mira dhe konsistente në zbatimin e detyrave me cilësi të lartë.....41
III. Shtylla III: Hetim dhe ndjekje të kryesve të veprave penale që reflekton profesionalizëm, përkushtim, efikasitet dhe respektim të plotë të lirive dhe të drejtave të njeriut përmes zbatimit të standardeve më të larta profesionale dhe etike.....42
Objektivat specifike.....43
1. Bashkëpunim me institucionet e sundimit të ligjit në rritjen e cilësisë së kallëzimeve penale dhe të hetimeve efektive.....43
2. Bashkëpunimi me institucionet përkatëse për kryerjen e ekspertizave në kohë...44
3. Konsolidimi i Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL).....45
4. Unifikimi i praktikave të punës brenda Prokurorit të Shtetit.....45
5. Zbatimi efektiv i procedurave të sekuestrimit dhe konfiskimit.....46
6. Zbatimi efektiv i procedurave alternative për zgjidhjen e rasteve.....47
7. Fuqizimi i mbrojtjes së viktimave të krimit.....48
IV. Shtylla IV: Prioretizimi i hetimit të veprave penale dhe ndjekjes së kryesve të krimit të organizuar, korrupsionit, krimeve ekonomike, pastrimit të parave, krimeve të luftës, terrorizmit dhe krimit kibernetik, dhunës në familje dhe krimeve të urrejtjes.....48
Objektivat specifike.....49
1. Fuqizimi i performancës së prokurorëve në luftimin e krimeve të luftës dhe terrorizmit.....49
2. Rritje e efikasitetit në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parave, krimeve ekonomike, trafikimi me qenie njerëzore dhe krimi kibernetik.....50
3. Qasje proaktive në trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe krimeve të urrejtjes.....51
V. Sigurimi i buxhetit për zbatimin e Planit strategjik.....52
VI. Monitorimi i zbatimit të Planit Strategjik.....53
VII. Përfundim.....53
VIII. Plani i veprimit.....55

**Shkurtesat**

**KPK** - Këshilli Prokurorial i Kosovës
**ZKPSH**- Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit
**PSRK** – Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
**PSH** – Prokurori i Shtetit
**SMIL** – Sistemi për Menaxhimin Elektronik të Lëndëve
**BE** – Bashkimi Evropian
**KGJK** – Këshilli Gjyqësor i Kosovës
**SKPK** – Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës
**NJSHPP** – Njësiti për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë
**EULEX** – Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit

## Hyrje

Plani Strategjik i sistemit prokurorial përcakton objektivat e punës së sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës në fuqizimin e një sistemi të qëndrueshëm, profesional dhe llogaridhënës në hetimin e veprave penale dhe ndjekjen e kryesve të tyre.

Ky plan përcakton një kornizë të qartë të punëve në zbatim të mandatit kushtetues dhe ligjor, duke u nisur nga konteksti aktual i performancës dhe synimet strategjike të sistemit dhe atyre shtetërore, duke u mbështetur në praktikat më të mira ndërkombëtare.

Hartimit të këtij plani i kanë paraprirë konsultimet me aktorët kryesorë të sistemit prokurorial, komentet dhe rekomandimet e Zyrës së BE-së, Projektit të Binjakëzimit, Ambasadës së SHBA-së, Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar, Holandës, Norvegjisë dhe partnerëve të tjerë, të cilët mbështesin proceset e punës.

Sikurse secili plan strategjik, edhe ky plan përmban politikat e institucionit dhe menaxhmentit të tij, krahasuar me strategjitë dhe kornizat e politikave të institucioneve në nivel shtetëror, ngaqë koordinimi i tillë siguron një planifikim të drejtë dhe të saktë, si dhe është garantues i rezultateve pozitive të tij.

Gjatë hartimit të këtij plani, grupi punues ka konsultuar dokumentet strategjike dhe legjislacionin në fuqi në nivel sektorial, në nivel vendi dhe ndërkombëtar, si dhe aktorët relevantë, me qëllim të krijimit të pasqyrës reale për përcaktimin e qëllimeve dhe objektivave strategjike.

Plani strategjik 2019-2021 përmban katër (4) shtylla kryesore, ku secila prej tyre ka një numër të objektivave specifike dhe do të  shërbejë si bazë për hartimin e planeve të punës për secilën njësi organizative të sistemit prokurorial.

Vizioni i sistemit prokurorial bazohet në rishikimin e situatës aktuale dhe nevojave për avancimin e mëtejshëm të sistemit në përputhje me zhvillimet përbrenda sistemit prokurorial dhe zhvillimeve në institucionet e tjera shtetërore.

Gjatë hartimit të këtij plani janë vlerësuar sfidat dhe rreziqet, të cilat mund të paraqiten në fazën e zbatimit të tij, që kanë të bëjnë me mundësinë e reformave në sektorin e drejtësisë, ndryshimet ligjore, nevojën për ndryshimin e akteve nënligjore, resurset buxhetore dhe kapacitetet njerëzore.

Gjithashtu, mbikëqyrja e realizimit të politikave dhe vendimeve brenda sistemit prokurorial do të zbatohet më e lehtë.

## KAPITULLI I

### 1. Struktura institucionale

Këshilli Prokurorial i Kosovës është përcaktuar si institucion i pavarur me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ndërsa funksionet i realizon në bazë të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe akteve përkatëse nënligjore.

Këshilli është institucion tërësisht i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij, i cili ka këto përgjegjësi kryesore:

i. Siguron që prokurorët të veprojnë në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme;
ii. Rekruton dhe propozon te Presidenti kandidatët për emërim dhe riemërim për prokurorë, përfshirë Kryeprokurorin e Shtetit;
iii. Vlerëson, ngrit në detyrë, disiplinon, propozon shkarkimin, transferon dhe ofron mbështetje për trajnimin e prokurorëve;
iv. Zgjedhë kryeprokurorët e prokurorive të të gjitha niveleve;
v. Themelon standardet për zhvillimin profesional të prokurorëve në bashkëpunim me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe
vi. Zhvillon politikat dhe strategjitë prokuroriale për luftimin efektiv të kriminalitetit, gjithashtu, siguron buxhetin, resurset njerëzore, infrastrukturën dhe shërbimet e nevojshme për funksionimin e Prokurorit të Shtetit.

Këshilli përbëhet nga trembëdhjetë (13) anëtarë, dhjetë (10) prej të cilëve janë prokurorë, ndërsa tre (3) anëtarë joprokurorë. Me bazën aktuale ligjore Këshilli përbëhet nga:

- Kryeprokurori i Shtetit sipas detyrës zyrtare (ex officio);
- Shtatë (7) anëtarë prokurorë, një (1) nga çdo prokurori themelore;
- Një (1) anëtar prokuror nga Prokuroria e Apelit;
- Një (1) anëtar prokuror nga Prokuroria Speciale;
- Një (1) anëtar avokat nga Oda e Avokatëve të Kosovës;
- Një (1) anëtar, profesor universitar i fakulteteve juridike dhe
- Një (1) anëtar, përfaqësues nga shoqëria civile.

Këshilli udhëhiqet nga Kryesuesi, i cili zgjidhet nga radhët e anëtarëve prokurorë të Këshillit, me mandat tre (3) vjeçar.

Kryesuesi i Këshillit paraqet raporte publike vjetore së paku një herë në vit për performancën, veprime0t, koston dhe nevojat buxhetore të sistemit prokurorial, si dhe organizon procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të komisioneve të përhershme sipas këtij ligji, duke i mundësuar Këshillit një proces transparent dhe të përgjegjshëm të propozimeve dhe emërimit të tyre.

Këshilli realizon mandatin e tij përmes punës së komisioneve të përhershme, të themeluara me ligj, të cilat janë si në vijim:

- Komisioni për Çështje Normative;
- Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve;
- Komisioni Disiplinor (deri në zbatim të ligjit për përgjegjësinë disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë);
- Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel dhe
- Komisioni për Administrimin e Prokurorive.

Për të realizuar mandatin e tij, Këshilli mund të themelojë edhe komisione të përkohshme.

Shërbimet për buxhetin, financat, prokurimin, burimet njerëzore, logjistikën, infrastrukturën, teknologjinë informative, për sistemin prokurorial, Këshilli i ofron përmes Sekretariatit të tij, ndërsa aspektet analitike, statistikore, të ngritjes profesionale të prokurorëve dhe personelit, Këshilli i realizon përmes Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë.

Prokurori i Shtetit është institucion kushtetues, i pavarur, i paanshëm me mandat dhe përgjegjësi për hetimin dhe ndjekjen e kryesve të veprave penale, struktura dhe kompetencat e të cilit rregullohen me ligj.

Ligji për Prokurorin e Shtetit përcakton funksionet dhe përgjegjësitë e tij, që, ndër tjera, përfshijnë: ushtrimin e funksioneve prokuroriale në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme, të sigurohen të gjithë personat për trajtim në mënyrë të barabartë, të zbatohen standardet më të larta të

kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare, të ketë sjellje të ndershme dhe profesionale në jetën personale dhe profesionale, duke u bazuar në ligjet e zbatueshme dhe kodin e etikës profesionale, mbrojtjen e të drejtave ligjore të viktimave, dëshmitarëve, të dyshimtëve, të akuzuarve dhe personave të dënuar, si dhe në ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme juridike për zbulimin e veprave penale dhe të autorëve të krimit, hetimin dhe ndjekjen me kohë të veprave penale.

Funksionimi i Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit me të gjitha njësitë e tyre organizative paraqitet si më poshtë.




## 2. Zhvillimi institucional

Pas hyrjes në fuqi të ligjeve për Këshillin Prokurorial dhe Prokurorin e Shtetit dhe ndryshimplotësimeve që kanë ardhur më vonë, janë përcaktuar edhe një sërë obligimesh për këto institucione, si në: hartimin dhe miratimin e infrastrukturës ligjore, krijimin e strukturave të reja organizative dhe mekanizmave të tjerë adekuatë, marrjen e vendimeve, përcaktimin e politikave dhe udhëzimeve në përmbushje të funksioneve ligjore.

Këshilli ka miratuar Planin strategjik 2016-2018, i cili përmbante katër (4) shtylla dhe nëntëmbëdhjetë (19) objektiva strategjike dhe ishte i shoqëruar edhe me dokumente të tjera përcjellëse për zbatim.

**I. Shtylla I: Fuqizimi i strukturës dhe kapaciteteve institucionale të sistemit prokurorial**

Gjatë periudhës që ka mbuluar ky plan, KPK-ja ka arritur të fuqizojë me sukses proceset e planifikimit, realizimit dhe kontrollit të buxhetit të sistemit prokurorial. Si rezultat i kësaj, buxheti për sistemin prokurorial për vitin 2018 ka arritur nga shtatë (7) milionë në vitin 2016 në 12 milionë.

Në anën tjetër, me kapacitete tërësisht vetanake dhe në konsultim me partnerët ndërkombëtarë dhe shoqërinë civile, kemi hartuar legjislacionin sekondar, i cili ka bërë të mundur zgjedhjen e anëtarëve, mënyrën e funksionimit dhe funksionalizimin e të gjitha komisioneve përkatëse të Këshillit dhe, ndër të tjera, është mundësuar edhe qartësimi i rolit dhe strukturës organizative të Sekretariatit.

Këshilli ka fuqizuar punën ekipore në frymën e këtij plani strategjik, duke krijuar në vazhdimësi kapacitetet për planifikim të politikave, hartimin e akteve normative, fuqizimin e komunikimit të brendshëm dhe bashkëpunimit me partnerë dhe donatorë. Në këtë aspekt, hartohen planet vjetore të punës së Këshillit, Prokurorit të Shtetit dhe njësive të tjera organizative të sistemit prokurorial, të cilat përcaktojnë objektiva dhe aktivitete specifike, të matshme dhe të përcaktuara në kohë.

**II. Shtylla II: Promovimi i kompetencave dhe profesionalizmit**

Këshilli, përmes akteve nënligjore, ka krijuar sistemin e ri të rekrutimit të bazuar në parimet e transperencës, meritokracisë, konkurencës dhe objektivizmit, si dhe në standarde të larta të administrimit të procesit, me ç'rast rezulton se në këtë periudhë janë rekrutuar 35% të numrit të përgjithshëm të prokurorëve dhe janë realizuar procese të rregullta të transferimit dhe avancimit, që kanë mundësuar rritjen e efikasitetit në zgjidhjen e rasteve nga Prokurori i Shtetit.

Gjatë kësaj periudhe, edhe numri i stafit administrativ është rritur në masë të konideueshme, në të cilë janë rekrutuar 218 zyrtarë. Po ashtu, sistemi i vlerësimit të performancës është konsoliduar dhe është rritur dinamika, duke mundësuar vlerësimin e rregullt për secilin prokurorë, me ç'rast gjatë tre vjetëve të kaluar janë vlerësuar 84 prokurorë me mandat të përhershëm dhe 106[1] prokurorë me mandat fillestar. Në këtë aspekt, Këshilli ka pasur rol aktiv në hartimin e programeve të trajnimit dhe politikave për trajnim, si dhe ka kontribuar në realizimin në kohë të proceseve disiplinore, përkatësisht, Komisioni Disiplinor ka mbajtur 76 seanca disiplinore dhe ka shqiptuar 40 masa disiplinore ndaj prokurorëve.

**III. Shtylla III: Zgjerimi i qasjes në drejtësi dhe marrëdhëniet me publikun**

Në frymën e këtij plani strategjik, Këshilli ka hartuar strategji specifike për komunikim publik dhe ka rekrutuar në secilin prokurori zyrtarë për komunikim publik dhe ka caktuar prokurorët përgjegjës për komunikim publik. Në funksion të fuqizimit të komunikimit, Këshilli ka nxjerrë akte për klasifikimin e dokumenteve zyrtare të sistemit prokurorial.

**IV. Shtylla IV: Përmirësimi i shërbimeve dhe teknologjisë**

Këshilli ka ridizajnuar uebfaqet e Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit dhe modernizuar shërbimet e teknologjisë informative, të cilat kanë ndikuar në rritjen e efikasitetit. Në këtë drejtim, veçanarisht është punuar për krijimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), duke përfshirë dhe krijimin e infrastrukturës adekaute, siç është pajisja me serverët më bashkëkohorë. Gjithashtu është bërë një hap i madh përpara edhe me digjitalizimin e procesit të menaxhimit të dosjeve të prokurorëve dhe aplikimit online për procedurat e rekrutimit.

## 1. Ndikimi i faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm për zbatimin e Planit strategjik 2019-2021

Plani strategjik i sistemit prokurorial shërben si një instrument orientues për Këshillin, Prokurorin e Shtetit dhe të gjitha njësitë organizative,

[1] Vlerësimi i performancës realizohet dy herë gjatë mandatit fillestar.

përfshirë administratën brenda sistemit prokurorial, i cili ka për qëllim fuqizimin e secilit sektor për të qenë koherent në kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj.

Plani është zhvilluar mbi bazën e vlerësimit të përparësive krahasuar me dobësitë e identifikuara të sistemit prokurorial, si dhe mundësitë me të cilat disponon sistemi përkundër rreziqeve potenciale të brendshme dhe të jashtme.

Ky vlerësim është bërë duke përdorur metodologjinë SWOT (Strengthening = Fuqitë, Weaknesses = Dobësitë, Opportunities = Mundësitë, Threatens = Rreziqet), e cila na ka mundësuar identifikimin dhe vlerësimin e fuqive dhe mundësive të sistemit prokurorial, me qëllim që të ndërmerren masat e duhuara në fazën e planifikimit dhe zbatimit të planit strategjik në drejtim të zvogëlimit apo eliminimit të dobësive dhe rreziqeve të mundshme.




**2. Përparësitë e identifikuara**

Sistemi prokurorial i Kosovës tashmë është në një fazë të konsoliduar. Funksionimi dhe organizimi i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit është përcaktuar me Kushtetutë, e cila është garantuese e funksionimit të pavarur, të paanshëm dhe efikas dhe konsiderohet si një ndër fuqitë kryesore të sistemit prokurorial.

Më tej, kjo çështje është e rregulluar me ligjet përkatëse, që, po ashtu, fuqizojnë parimet bazë të organizimit dhe funksionimit të sistemit prokurorial.

Duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, Këshilli ka një përbërje funksionale, megjithëse, me disa mungesa për funksionim me përbërje të plotë. Legjislacioni sekondar është i nivelit të kënaqshëm, struktura organizative është e qartë dhe në funksionim të plotë, ndërsa burimet njerëzore janë duke u rritur dhe forcuar kapacitetet profesionale. Buxheti ka shënuar rritje të konsiderueshme dhe digjitalizimi i proceseve të punës ka shënuar përparim.

Në aspektin organizativ dhe funksional, përparësitë e sistemit prokurorial janë si në vijim:

- Pavarësia dhe paanshmëria e sistemit prokurorial, të garantuara me Kushtetutë;
- Organizimi, funksionimi dhe kompetencat, të përcaktuara me ligj;
- Legjislacioni sekondar është i përfunduar dhe është në fazën e rishikimit bazuar në analizat dhe vlerësimet e punës;
- Numri i prokurorëve dhe stafit mbështetës është rritur në mënyrë të konsiderueshme, ndërsa politikat për avancim profesional janë të nivelit të avancuar;
- Sistemi i rekrutimit, avancimit, transferimit dhe disiplinimit funksional ka dhënë rezultate pozitive;
- Sistemi i futjes së të dhënave, përpunimit dhe raportimit bazohet kryesisht në teknologjinë informative;
- Planifikimi i buxhetit dhe infrastruktura fizike janë në gjendje të qëndrueshme për të garantuar funksionalitet të plotë dhe
- Bashkëpunimi i mirë me institucione vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë donatorët;

**3. Vështirësitë e sistemit prokurorial**

Sistemi prokurorial, gjithashtu, ballafaqohet me vështirësi në punën e tij, të cilat kërkojnë trajtim adekuat dhe adresim për përmirësim. Kompleksiteti i sistemit prokurorial, intensiteti i ndryshimeve legjislative dhe organizative, numri i lartë i të punësuarve me profile të ndryshme determinojnë edhe vështirësitë me të cilat ballafaqohet dhe që kërkojnë trajtim profesional dhe konsistent nga ana e menaxhmentit.

Në këtë drejtim, vështirësitë e sistemit prokurorial janë vlerësuar si më poshtë:

- Nevoja për riorganizim dhe ngritje të kapaciteteve të resurseve aktuale për planifikim dhe mbikëqyrje të proceseve të punës;
- Mungesa e një analize dhe vlerësimi gjithëpërfshirës për funksionimin e sistemit prokurorial;
- Mosidentifikimi i faktorëve që ndikojnë në rezultatet e punës;
- Mungesa e buxhetit për ekspertiza të ndryshme dhe përkthimi në procedurë gjyqësore;
- Prezantimi i pamjaftueshëm i rezultateve të punës para publikut, mediave dhe shoqërisë civile;
- Inpute të pamjaftueshme nga ana e prokurorive themelore për përcaktimin e politikave afatshkurtra dhe afatmesme;
- Kërkesat për specializime në trajtimin e krimeve specifike dhe
- Rritja e besimit të publikut.

## 4. Mundësitë e sistemit prokurorial

Procesi i avancimit të vazhdueshëm të sistemit prokurorial të Kosovës, përcjellja e trendit të veprave të reja penale dhe llojet e veprave penale më karakteristike, në kontekst të angazhimit të vazhdueshëm për sigurimin e sundimit të rendit dhe ligjit, si dhe në përmbushjen e standardeve ndërkombëtare, veçmas për procesin e integrimit evropian, janë treguesit më të qartë për krijimin dhe shfrytëzimin e mundësive të reja të krijuara në sistemin prokurorial të Kosovës.

Në këtë kontekst, mundësitë e sistemit prokurorial, të vlerësuara për këtë plan strategjik, janë si në vijim:

- Planifikimi dhe përgatitja e projekteve që reflektojnë nevojat e sistemit për mbështetje nga donatorët;
- Avancimi i bashkëpunimit ndërinstitucional;
- Përcaktimi i procedurave standarde të punës për profile të caktuara brenda sistemit prokurorial;
- Rritja e besimit të publikut nëpërmjet avancimit të shërbimeve të informimit, komunikimit publik dhe marrëdhënieve me media;

- Përmirësimi e kornizës ligjore që ka të bëjë me funksionimin e sistemit prokurorial;
- Shfrytëzimi i përparësive që ofron teknologjia informative e aplikueshme në sistemin prokurorial;
- Zhvillimin profesional të prokurorëve për të kryer hetime penale më komplekse, veçanërisht krimet e kryera gjatë ushtrimit të detyrave publike;
- Rritjen e llogaridhënies dhe vlerësimit substancial dhe cilësor të prokurorëve dhe stafit mbështetës;
- Krijimi i sistemit për funksionet këshilluese dhe të mentorimit për transferimin e njohurive nga prokurorët me përvojë më të gjatë te prokurorët me më pak përvojë dhe
- Zhvillimi profesional i personelit të administratës së sistemit prokurorial, në mënyrë që ata të mund të kryejnë plotësisht funksionet e tyre në institucionin e prokurorisë.

## 5. Rreziqet e sistemit prokurorial

Rreziqet janë faktorë të jashtëm, të cilët kanë ndikim në shkallën e përmbushjes së objektivave të përcaktuara në planin strategjik, prandaj edhe kërkojnë vëmendje të shtuar në fazën e planifikimit dhe zbatimit. Kjo kërkon krijimin e një qasjeje që krijon mundësi për menaxhimin e rreziqeve apo shkallës së ndikimit të tyre në rezultatet e punës.

Rreziqet e parashikuara me këtë plan janë si më poshtë:

- Ndryshimet e shpeshta të legjislacionit me ndikim në punën e sistemit prokurorial;
- Proceset për reforma strukturore dhe substanciale brenda sistemit të drejtësisë;
- Mosaprovimi i kërkesave buxhetore në përmbushje të mandatit ligjor të sistemit prokurorial dhe trajtimi i pabarabartë me dy pushtetet e tjera shtetërore;
- Mungesa e burimeve njerëzore dhe financiare për të përballuar fluksin dhe intensitetin e punëve të grumbulluara dhe atyre në ardhje e sipër;

- Ndryshimi i procesit të punës nga metoda manuale në atë elektronike dhe
- Kostoja, cilësia dhe kohëzgjatja e ekspertizave dhe përkthimi në gjuhë specifike gjatë zhvillimit të procedurës penale.

## KAPITULLI II

### 1. Misioni

Sistem i pavarur, i paanshëm, profesional dhe efektiv i hetimit dhe i ndjekjes penale nga prokurorë të rekrutuar në bazë të meritës, të vlerësuar në bazë të rezultateve në punë dhe të mbikëqyrur sipas standardeve të larta, i cili siguron zbatimin e ligjit në mënyrë të drejtë e pa dallime dhe i trajton në mënyrë meritore viktimat e krimit.

### 2. Vizioni

Të ofrojmë trajtim të barabartë para ligjit në mënyrë efikase, efektive, transparente, llogaridhënëse dhe profesionale, e cila siguron besimin e publikut.

### 3. Vlerat

Sistemi prokurorial në punën e tij do të udhëhiqet nga standarde dhe vlera si:

- Profesionalizmi dhe pavarësia në punë;
- Qasje të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë;
- Shfrytëzim racional të resurseve;
- Efikasitet dhe efektivitet në punë;
- Integritet dhe etikë e lartë dhe
- Llogaridhënie dhe transparencë.

### 4. Supozimet

Qëndrueshmëria e këtij plani strategjik varet nga supozimet, si në vijim:

- Forcimi i garancioneve kushtetuese dhe ligjore që fuqizojnë pavarësinë e sistemit prokurorial;
- Buxhet i mjaftueshëm për funksionimin dhe kryerjen e mandatit ligjor të sistemit prokurorial në mënyrë të pavarur;

- Burime të mjaftueshme njerëzore, profesionale dhe të motivuar për zbatimin e Planit Strategjik;
- Ekip kompetent të menaxhimit që është i angazhuar për të zbatuar bashkërisht të gjitha masat strategjike dhe të udhëheq sistemin prokurorial në realizimin e misionit të tij;
- Këshill Prokurorial i motivuar dhe i gatshëm për të planifikuar dhe zbatuar masat e adekuate për zbatim të këtij.
- Kuptim i nevojave reale dhe një angazhim i fortë në lidhje me masat e nevojshme për të zbatuar Planin Strategjik;
- Monitorim dhe vlerësim rigoroz i zbatimit të këtij plani strategjik;

## KAPITULLI III

### 1. Qëllimet dhe shtyllat strategjike

Synimet e sistemit prokurorial në arritjen e vizionit të përcaktuar me këtë plan strategjik dhe misionit të përcaktuar me Kushtetutë dhe ligj janë të përmbledhura në katër shtylla strategjike. Secila shtyllë përmban objektiva specifike dhe të matshme, me ç'rast secila prej tyre konkretizohet me veprime specifike.

Ky plan strategjik përmban edhe planin e veprimit, ku për secilën shtyllë dhe secilin objektiv strategjik janë aktivitetet e përcaktuara, përgjegjësit për kryerjen e tyre dhe afatet kohore.

Ndër të tjera, plani parasheh edhe monitorimin dhe vlerësimin sistematik.

Shtyllat kryesore strategjike të sistemit prokurorial për periudhën 2019-2021 janë si në vijim:

• Fuqizimi i efikasitetit dhe efektivitetit të administrimit të sistemit prokurorial;
• Fuqizimi i kapaciteteve institucionale dhe profesionale përmes përmirësimit të integritetit, llogaridhënies dhe transparencës të së sistemit prokurorial;
• Hetim dhe ndjekje të kryesve të veprave penale që reflekton profesionalizëm, përkushtim, efikasitet dhe respektim të plotë të lirive dhe të drejtave të njeriut përmes zbatimit të standardeve më të larta profesionale dhe etike dhe
• Prioritetizim i hetimit të veprave penale dhe ndjekjes së kryesve të krimit të organizuar, korrupsionit, krimeve ekonomike, pastrimit të parave, krimeve të luftës dhe terrorizmit dhe krimit kibernetik.

### I. Shtylla I: Fuqizimi i efikasitetit dhe efektivitetit të administrimit të sistemit prokurorial

Sistemi i drejtësisë, në përgjithësi dhe sistemi gjyqësor dhe prokurorial, në veçanti, kanë kaluar nëpër reforma të shumta. Sistemi prokurorial për vite me radhë është ballafaquar me numër në rritje të lëndëve dhe numër të pamjaftueshëm të prokurorëve dhe stafit administrativ.

Si rezultat, është rritur numri i lëndëve të vjetra dhe detyrimisht ka pasur vonesa në kryerjen e tyre. Andaj, raportet vendore dhe ndërkombëtare kanë vlerësuar se sistemi prokurorial është në fazë të hershme të konsolidimit dhe progresi është shumë i vogël. Në këtë kontekst është rekomanduar që të ndërmerren masa konkrete për fuqizimin e pavarësisë, llogaridhënies, paanësisë dhe efikasitetit të sistemit prokurorial.

Gjithashtu, në këtë aspekt, nga viti 2015, si rezultat i planifikimit më të mirë, fuqizimit të llogaridhënies, angazhimit të menaxhmentit të lartë në arritjen e aktiviteteve të planifikuara, është shënuar progres i dukshëm në performancën e sistemit prokurorial. Vetëm në dy vitet e fundit është rritur për 35% numri i prokurorëve dhe është rekrutuar një numër i konsiderueshëm i personelit mbështetës. Si rezultat i një planifikimi më të mirë dhe shpenzimi efektiv është rritur buxheti i sistemit prokurorial.

Një proces shumë i rëndësishëm është edhe vënia në zbatim të plotë të Sistemit të Menaxhimit Informativ të Lëndëve (SMIL), i cili është në fazën e fillimit të zbatimit të tij. Funksionalizimi i SMIL-it do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit prokurorial. Ky sistem mundëson edhe rritjen e llogaridhënies dhe fuqizimin e integritetit, baza këto, të cilat janë të rëndësishme për hartimin e politikave përmes matjes së trendëve të lëndëve të pranuara dhe të trajtuara, përfshirë dhe përcjelljen e trendëve të kriminalitetit.

Administrimi i sistemit prokurorial duhet të forcohet në rritjen e efektivitetit të punës së personelit dhe të ketë llogaridhënie të shtuar. Në këtë drejtim, fokusi i sistemit prokurorial do të jetë në rishikimin e strukturës organizative të administratës së sistemit prokurorial, ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale, digjitalizimin e proceseve të punës, fuqizimin e llogaridhënies dhe vlerësimit të performancës. Ky proces rishikimi mund të krijojë nevojën për buxhet dhe burime njerëzore shtesë.

Procesi i planifikimit afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, konsiderohet si një mundësi për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në punë, prandaj do t'i kushtohet vëmendje e posaçme ngritjes së kapaciteteve në drejtim të përmbushjes së këtij qëllimi.

**Objektivat specifike**

**1. Fuqizimi i kornizës ligjore dhe strukturës organizative të sistemit prokurorial**

Sistemi prokurorial është kategori kushtetuese dhe, sipas legjislacionit në fuqi, funksionon i pavarur nga institucionet dhe pushtetet e tjera. Në këtë mënyrë, duke u bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe barazisë së tyre, çdo iniciativë apo sponzorizues i ligjeve, në procesin e hartimit të legjislacionit që rregullon sistemin e drejtësisë dhe afekton sistemin prokurorial, do të duhej të përfshijë kërkesat dhe propozimet e sistemit prokurorial në procesin për plotësimndryshime të reja në legjislacionin aktual.

Duke marrë në konsideratë praktikat më të mira dhe traditën e sistemit prokurorial në Kosovë, synimi është që të ruhet karakteri unitar i sistemit prokurorial dhe të bazohet në parimet e pavarësisë dhe subordinimit, si baza përcaktuese për shumicën e sistemeve prokuroriale.

Sistemi i drejtësisë, përfshirë dhe atë prokurorial, në raporte të ndryshme ka marrë rekomandime për të fuqizuar llogaridhënien dhe për të rritur efektivitetin në punë. Andaj, synimi është që të rishikohet struktura organizative e administratës së sistemit prokurorial në funksion të rritjes së llogaridhënies dhe efektivitetit në punë.

KPK-ja do të ketë synim kryesor arritjen e përbërjes së plotë të KPK-së me anëtarë joprokurorë. Përbërja aktuale jo e plotë nuk përfaqëson qëllimin e ligjdhënësit për funksionimin e Këshillit në sistemin prokurorial.

Këshilli do të zhvillojë një proces të hapur dhe transparent të përzgjedhjes së anëtarëve të KPK-së, pas përfundimit të mandatit të anëtarëve aktualë.

Për këtë qëllim, Këshilli do të krijojë mekanizma të brendshëm, të cilët do të kontribuojnë me rekomandime për plotësimndryshimin e legjislacionit ekzistues, për hartimin e akteve të reja duke u bazuar në praktikat më të mira për hartimin e akteve nënligjore, të përfshihen në procesin legjislativ në grupe punuese dhe të bëjë monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të legjislacionit,

i cili ka ndikim në sistemin e prokurorial, me qëllim që të mbështetet puna e sistemit prokurorial.
Këshilli do të bëjë propozim dhe të shtyjë përpara diskutimet për krijimin e një sistemi, në të cilin anëtarët prokurorë të Këshillit janë me punë të përhershme në Këshill gjatë mandatit të tyre.

## 2. Avancimi i statusit dhe rolit të prokurorëve dhe personelit administrativ

Duke u bazuar në nenin 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku përcaktohet ndarja e pushteteve, theksohet qartësisht se pushteti gjyqësor është i ndarë dhe i barabartë me pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv.

Duke u mbështetur në të drejtën e dhënë me Kushtetutë duhet që statusi i sistemit prokurorial të jetë i barabartë me statusin e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv.

Në këtë kuptim, sistemit prokurorial i garantohet pavarësia për ushtrimin e funksioneve kushtetuese dhe ligjore, trajtimi i barabartë me pushtetet e tjera në aspektin buxhetor dhe të të drejtave të tjera institucionale në përfaqësim.

Institucioni i Prokurorit të Shtetit është institucion kushtetues, i pavarur dhe unik, andaj përbrenda strukturës së tij mund të krijohen njësi të specializuara, me qëllim të ngritjes së efikasitetit në hetimin dhe ndjekjen e krimeve specifike. Këto mundësi do të realizohen duke përcaktuar procedurën me akt nënligjor të miratuar nga Këshilli, duke vlerësuar rolin e pamohueshëm të Kryeprokurorit të Shtetit në këtë proces. Njësitë e specializuara mund të kenë një shkallë të caktuar të autonomisë funksionale, llogaridhënies dhe pozitës së tyre brenda Prokurorit të Shtetit, megjithatë, duhet të ruhet mbikëqyrja nga Këshilli. Kriteret për caktim të prokurorëve në këto njësi duhet të mbeten të barabarta dhe të bazuara në një proces të hapur konkurrues, transparent, meritokrat dhe me përvojë relevante sipas profileve të nevojshme.

Të gjithë të punësuarit në administratën e sistemit prokurorial duhet të jenë nëpunës civil me status të veçantë, ku Këshilli sipas parimeve të përgjithshme të nëpunësve civil rregullon procesin e klasifikimit, vlerësimit, rekrutimit,

transferimit dhe avancimit, të drejtat ose detyrimet specifike, zhvillimin e karrierës dhe aftësimin profesional.

Në kuadër të sigurisë së prokurorëve dhe personelit administrativ duhet të përfshihet ndërtimi i një sistemi që ofron siguri personale përmes institucioneve përgjegjëse të sigurisë dhe sigurimi shëndetësor si e drejtë sociale e garantuar me instrumente ndërkombëtare. Siguria personale e prokurorëve ndihmon dhe garanton efektivitetin dhe efikasitetin në punën e prokurorit të shtetit, në mënyrë të pavarur dhe të paanshme. Trajtimi i barabartë me dy pushtet e tjera, duke siguruar të gjitha të drejtat dhe privilegjet për trajtim, përfshirë: pagat, sigurinë, sigurimin shëndetësor, mirëqenin, kushtet e punës, mbrojtjen ligjore dhe mbështetjen administrative.

Këshilli do të angazhohet që nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm në procesin ligjdhënës të sigurojë se Ligji për pagat e zyrtarëve publikë do të garantojë trajtimin e barabartë të ndarjes së pushteteve, duke trajtuar pushtetin gjyqësor në nivel të njëjtë me dy pushtetet e tjera - atë legjislativ dhe ekzekutiv.

### 3. Llogaridhënia sistematike dhe kontrolli permanent i punës së prokurorëve

Efikasiteti, efektiviteti dhe cilësia e punës së prokurorëve do të jenë në vëmendje të shtuar të Këshillit. Për këtë qëllim, Këshilli do të krijojë mekanizma për monitorim të punës së prokurorëve, jo vetëm në nivel sasior, por edhe cilësor të punës. Kjo do të arrihet përmes përcjelljes permanente të sjelljes dhe punës së prokurorëve, duke synuar krijimin e një sistemi të përhershëm monitorimi dhe vlerësimi, që do të ndikonte në rritjen e nivelit të llogaridhënies për punën e tyre.

Këshilli do të themelojë një mekanizëm, i cili do të vlerësojë hudhjet e kallëzimeve penale në nivel individual dhe institucional. Procedura e punës së këtij mekanizmi do të përcaktohet përmes akteve përkatëse rregullative dhe, në të njëjtën kohë, do të krijohen kushte adekuate pune. Vlerësimi i hudhjeve do të jetë pjesë e vlerësimit të performancës së përgjithshme të prokurorit dhe udhëheqësve të prokurorive përkatëse.

Vlerësimi i performancës në punë dhe integriteti i prokurorëve janë çështje të ndryshme të cilat mund të kenë ndikim në vlerësimin e prokurorëve si dhe ndërmarrjen e masave adekuate në varësi të rezultateve të punës apo sjelljes etike dhe integritetit.

Integriteti dhe sjelljet etike do të monitorohen ex officio dhe në mënyrë permanente nga Këshilli, pavarësisht ankesave apo paraqitjes së pakënaqësive të palëve në procedurë. Kjo do të ndikojë dukshëm në rritjen e performancës së punës së sistemit prokurorial dhe besimit të publikut në këtë sistem.

Llogaridhënia do të përfshijë edhe sjelljet etike dhe integritetin e secilit pjesëtar të sistemit prokurorial në cilindo nivel qoftë. Kjo do të ndikojë në ndërtimin e sistemit të vetëkontrollit të verifikimit të integritetit personal, në njërën anë, dhe atij institucional, në anën tjetër.

KPK-ja do të ketë fokus të veçantë në forcimin e kapaciteteve menaxheriale të kryeprokurorëve dhe udhëheqësve të departamenteve, ngaqë vlerëson se është parakusht për sigurimin e punës cilësore të prokurorëve dhe prokurorive.

Për të dalë në mbështetje të prokurorëve, me qëllim të shmangies së situatave kur ka dilema etike dhe rritjen e integritetit të tyre, Këshilli do të bëjë të mundur ofrimin e këshillave adekuate për prokurorët sipas rasteve kur ata e vlerësojnë një gjë të tillë të nevojshme. Kjo do të ndikonte në uljen e rasteve të shkeljeve etike, rasteve disiplinore dhe do të kishte ndikim pozitiv në rritjen e integritetit të sistemit prokurorial dhe besimit të publikut në sistem.

**4. Transparenca dhe komunikimi publik**

Këshilli përcakton mekanizmat e komunikimit publik dhe pushtetet e tjera shtetërore me akte përkatëse normative. Komunikimi ndërinstitucional rregullohet në pajtim të plotë me parimin e pavarësisë dhe ndarjes së pushteteve.

Këshilli dhe Prokurori i Shtetit ballafaqohet në fushën e komunikimit publik me mungesën e standardizimit dhe unifikimit të informacionit të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe menaxhimit eventual të situatave të veçanta në komunikimin publik, gjë që nënkupton mungesë të theksuar të koordinimit të zyrtarëve të lartë. Në këtë kontekst, Këshilli do të zhvillojë një program efektiv për përmirësimin e imazhit dhe perceptimit pozitiv të publikut në sistemin prokurorial, përmes promovimit të punës së prokurorëve dhe prokurorive.

Me qëllim të ngritjes së transparencës në marrëdhëniet me publikun është hartuar Strategjia e Komunikimit Publik e Sistemit Prokurorial të Kosovës (2018-2020), e cila përmban bazën trevjeçare orientuese të fushëveprimtarisë së komunikimit publik. Në këtë kuadër është paraparë forcimi i kapaciteteve profesionale dhe roli proaktiv në komunikimin publik. Kjo strategji do të rishikohet në përputhje me strategjinë e sistemit prokurorial.

Me qëllim të avancimit të shërbimit të komunikimit publik dhe ofrimit të njohurive për veprimtarinë përfaqësuese të sistemit prokurorial, si dhe përmbushjes së zotimit kushtetues për komunikim me qytetarët, por duke respektuar gjithmonë parimin e konfidencialitetit, sistemi prokurorial synon që bazuar në standarde të larta etike dhe profesionale të prezantojë sa më mirë veprimtarinë prokuroriale me anë të komunikimit publik të cilësisë së lartë dhe shkëmbimin e praktikave dhe përvojave më të mira.

Në funksion të kësaj do të dizajnohet një portal unik i sistemit prokurorial dhe një gjë e tillë parashihet të bëhet edhe në kuadër të rrjeteve sociale. Shtrirja e rregullt e përmbajtjes elektronike do të pasqyrojë misionin, ndjeshmërinë, rolin dhe specifikat e punëve dhe detyrave të tyre. Po ashtu, në kuadër të fuqizimit dhe avancimi të komunikimit publik, do të bëhen edhe plotësimndryshimet e nevojshme të Rregullores për shërbimin e komunikimit publik dhe do të hartohen edhe udhëzues relevantë dhe procedura standarde të veprimit, në mënyrë që të kemi një komunikim efektiv publik.

Rregullorja për klasifikimin e dokumenteve përcakton qartë se cilat dokumente janë të hapura dhe cilat të klasifikuara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Megjithatë, zbatimi i kësaj rregulloreje kërkon një vëmendje të shtuar, prandaj nevojitet edhe krijimi i infrastrukturës së nevojshme operative për zbatimin e plotë të rregullores, gjë që do të arrihet brenda periudhës së zbatimit të planit strategjik. KPK-ja do të hartojë udhëzues dhe manualë për prokurorë dhe stafin mbështetës administrativ lidhur me dokumentet e klasifikuara, si dhe do të mbajë trajnimet e nevojshme përmes pjesëmarrjes në trajnime apo përmes trajnimeve online.

**5. Sigurimi i infrastrukturës fizike adekuate**

Krahas sfidave në punën e sistemit prokurorial për përmbushjen e mandatit ligjor, sistemi prokurorial është ballafaquar edhe me një infrastrukturë fizike joadekuate, të vjetruar dhe me hapësira të pamjaftueshme për punë.

Padyshim që infrastruktura fizike është tejet e rëndësishme për punën e sistemit prokurorial dhe direkt e ndërlidhur me efikasitetin dhe efektivitetin e tij. Në këtë drejtim, Këshilli ka përmirësuar në vazhdimësi infrastrukturën e sistemit prokurorial. Megjithatë, infrastruktura fizike mbetet ende nevojë për ndërhyrje në modernizimin e saj përfshirë dhe sigurimin e objekteve për disa prokurori.

**6. Bashkëpunimi me institucionet vendore, i mbështetur në respekt reciprok**

Bashkëpunimi i Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare është i përcaktuar me Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligjin e Prokurorit të Shtetit, aktet e tjera nënligjore dhe strategjitë. Ky bashkëpunim është realizuar me qëllim të arritjes së objektivave të sistemit prokurorial.

Këshilli dhe Prokurori i Shtetit kanë zbatuar politikën e bashkëpunimit interaktiv dhe profesional me institucione shtetërore dhe organizata të tjera vendore, si: Presidencën e Kosovës, Kuvendin e Kosovës, Qeverinë e Kosovës, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ministrinë e Drejtësisë, Akademinë e Drejtësisë, Odën e Avokatëve të Kosovës, Policinë e Kosovës dhe institucionet e tjera të zbatimit të ligjit.

Ky bashkëpunim synohet të vazhdojë edhe në të ardhmen në formë të lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe memorandumeve të mirëkuptimit, me qëllim të realizimit të mandatit ligjor.

Vend të veçantë në kuadër të këtij bashkëpunimi do të ketë Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me fokus në koordinimin e aktiviteteve dhe mbledhjeve të përbashkëta, veçanërisht për çështjet që kanë të bëjnë me sigurimin dhe mbrojtjen e statusit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit mbështetës, fuqizimin e pavarësisë dhe paanshmërisë, rritjen e efikasitetit të punës së prokurorive dhe gjykatave, akomodimin e stafit të ish Zyrës së Prokurorit Disiplinor dhe aspekte të tjera të punës në kuadër të mandatit ligjor, si dhe Akademinë e Drejtësisë lidhur me procesin e vlerësimit të nevojave për trajnime, hartimin e programeve të trajnimit, vlerësimin e prokurorëve të sapoemëruar pas përfundimit të trajnimit fillestar, koordinimin e pjesëmarrjes në trajnime, përzgjedhjen e mentorëve dhe vlerësimin e ndikimit të trajnimeve në punën e prokurorëve.

Këshilli dhe Prokurori i Shtetit mbeten të përkushtuar në zbatimin e politikave të bashkëpunimit të hapur dhe profesional me institucione shtetërore dhe organizata tjera vendore.

**7. Bashkëpunimi me partnerë ndërkombëtarë dhe donatorë**

Këshilli dhe Prokurori i Shtetit kanë vazhduar bashkëpunimin reciprok me donatorë dhe partnerë ndërkombëtarë, si: Ambasadën Amerikane, Zyrën e BE-së në Prishtinë, Qeverinë Norvegjeze, UNDP-në, agjencitë e tjera të Kombeve të Bashkuara, EULEX-in, Këshillin e Evropës, IRZ-në, GIZ-in, etj. Ky bashkëpunim ka rezultuar me ofrimin e mbështetjes për ngritjen e kapaciteteve të përgjithshme prokuroriale dhe praktikave më të mira për përmirësimin e procesit të planifikimit të punës në çdo nivel. Kjo është arritur përmes takimeve koordinuese me donatorë, marrëveshjeve të bashkëpunimit, projekteve të donatorëve, trajnimeve, financimit të projekteve kapitale, vizitave studimore dhe programeve për shkëmbim të përvojave, me qëllim të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të kapaciteteve të prokurorëve dhe stafit administrativ. Progresi i deritashëm i sistemit prokurorial është pa dyshim sukses i përbashkët dhe i pandarë me partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët.

Përvoja e deritashme është një bazë e mirë, mbi të cilën, Këshilli dhe Prokurori i Shtetit do të avancojnë bashkëpunimin dhe, njëkohësisht, rrisin qëndrueshmërinë e projekteve të financuara nga donatorët dhe partnerët. Në këtë aspekt, mbështetur në këtë plan strategjik, do të zhvillohen plane konkrete që do të përcaktojnë nevojat, duke u bazuar në politikat e sistemit prokurorial dhe mundësitë e partnerëve dhe donatorëve për mbështetje.

Këshilli dhe Prokurori i Shtetit do të luajnë rol proaktiv që në bashkëpunim të ngushtë me partnerët të zhvillojnë projekte ku me ndërmarrje të përbashkëta të arrijmë synimet për një sistem prokurorial efikas, efektiv dhe profesional. Për më tepër, Këshilli do të jetë pjesë aktive e koordinimit të punës me donatorë, partnerë ndërkombëtarë dhe institucione të tjera të sektorit të drejtësisë në nivel reciprociteti të plotë dhe në mënyrë rotative të udhëheqim me një trup, që do të mund të koordinonte bashkëpunimin.

Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet zbatimit të projekteve aktuale me donatorë dhe propozimit të projekteve të reja, përmes së cilave do të vazhdojnë të ngritën kapacitetet e Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit në drejtim të aplikimit të standardeve më të larta ndërkombëtare në realizim të mandatit të sistemit prokurorial.

Synohet fillimi i realizimit të projekteve me Institutin Ndërkombëtar të Siracusa-s për të Drejtën Penale dhe të Drejtat e Njeriut, Qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar, Qeverinë e Irlandës Veriore dhe projekte të tjera, që synohen të realizohen me partnerët ndërkombëtarë.

Këshilli dhe Prokurori i Shtetit, po ashtu, synojnë të vazhdojnë bashkëpunimin me institucionet simotra, në veçanti ato të rajonit, përmes formave të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, shkëmbimit të përvojave dhe ngritjes së kapaciteteve të sistemit prokurorial. Gjithashtu, Këshilli do të ofrojë resurset e veta edhe në drejtim të përmbushjes së detyrimeve që dalin nga proceset e integrimit evropian dhe çfarëdo obligimi tjetër shtetëror.

Këshilli dhe Prokurori i Shtetit mbeten të përkushtuar për zbatimin e politikave të bashkëpunimit të hapur dhe profesional me institucione shtetërore dhe organizata e tjera ndërkombëtare.

Me qëllim të avancimit të bashkëpunimit vendor dhe ndërkombëtar do të themelohet një mekanizëm i brendshëm për koordinim me donatorë për hartimin dhe menaxhimin e projekteve të ndryshme, si dhe për përgatitjen e rekomandimeve, që dalin si rezultat i projekteve, përfshirë edhe monitorimin dhe raportimin e realizimit të këtyre rekomandimeve. Ky mekanizëm do të shërbejë edhe si njësi për planifikime strategjike.

**8. Teknologjia informative dhe menaxhimi i të dhënave**

Edhe pse teknologjia informative është avancuar në një shkallë të kënaqshme në vitet e fundit, sistemi prokurorial ka nevojë ende për avancimin e mëtejmë të teknologjisë informative dhe ngritjen e kapaciteteve të personelit në përdorimin e saj. Në këtë drejtim, në periudhën që mbulon ky plan strategjik synohet që krahas trendëve të zhvillimit të teknologjisë informative të punohet në avancimin e mëtejmë të saj dhe në digjitalizimin e plotë të proceseve të punës, përfshirë ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore për aplikimin e TI-së.

Fokusi do të jetë në zbatimin e projektit të Sistemit të Menaxhimit Informativ të Lëndëve (SMIL). Këshilli do të vërë në dispozicion të këtij projekti resurset e nevojshme njerëzore dhe financiare për të vlerësuar nevojën e zhvillimit të moduleve të reja dhe përditësimin e ekzistueseve, me qëllim të funksionalizimit të plotë të tij, për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit prokurorial.

Këshilli dhe prokuroritë do të organizojnë tryeza pune dhe do të ndërmarrin një fushatë, si dhe do të publikojnë udhëzues dhe broshura informuese për të ngritur vëmendjen e stafit të sistemit prokurorial për zbatimin e këtij sistemi.

Synimi do të jetë që të largohet sistemi i vjetër i punës për t'u zëvendësuar me punën në formë elektronike në masën më të madhe të mundshme. Këshilli do të mbështesë sektorin e IT-së me tërë infrastrukturën e nevojshme në funksion të zbatimit të SMIL-it.

Ky projekt kërkon angazhimin e të gjithë të punësuarve në sistemin prokurorial, prandaj edhe ngritja e kapaciteteve të tyre paraqitet si nevojë e domosdoshme.

Lidhur me këtë, Këshilli do të inkurajojë ekspertët e fushës që të përgatisin programe trajnimi për secilën kategori dhe do të kërkojë nga personeli të përfshihen në trajnimet e nevojshme për ngritjen e kapaciteteve në aplikimin e teknologjisë informative.

**9. Avancimi i rolit institucional në proceset buxhetore dhe financiare**

Sipas ligjit, Këshilli në bashkëpunim me Prokurorin e Shtetit planifikon dhe menaxhon buxhetin vjetor, në mënyrë të pavarur për tërë sistemin prokurorial. Kërkesat buxhetore sipas ligjit dërgohen drejtpërdrejt në Kuvend dhe Ministrinë e Financave. Ministria e Financave shqyrton kërkesat buxhetore dhe përcakton kufijtë buxhetorë, të cilët në fund me projektligj aprovohen nga Qeveria dhe propozohen në Kuvend. Kufijtë buxhetorë të përcaktuar me projektligjin e buxhetit edhe përkundër angazhimit dhe përpjekjeve të bëra nga Këshilli gjatë gjithë procesit të buxhetit vjetor nuk reflektojnë në tërësi kërkesat e Këshillit dhe kjo e vështirëson realizimin e aktiviteteve të planifikuara në realizimin e nevojave të sistemit prokurorial. Pavarësisht faktit që buxheti ka shënuar rritje mungesa e mjeteve në disa kategori ekonomike ende mbetet sfidë e Këshillit.

Nga procesi i rishikimit funksional të sektorit të drejtësisë pavarësia buxhetore e sistemit prokurorial, si një ndër çështjet kruciale për funksionimin e sistemit prokurorial, duhet të garantohet me kushtetutë dhe ligj. Buxheti i sistemit prokurorial planifikohet dhe hartohet në konsultim me të gjitha prokuroritë dhe miratohet nga Këshilli. Miratimi i buxhetit përmes ligjit të buxhetit duhet të reflektoj nevojat e përcaktuara dhe të vlerësuara nga vet Këshilli. Kufijtë buxhetor duhet të sigurojnë ushtrimin e funksioneve prokuroriale, sigurimin e numrit të nevojshëm të prokurorëve dhe personelit administrativ, paga të barabarta me dy pushtetet tjera, krijimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e infrastrukturës dhe kushteve të nevojshme dhe adekuate për punë. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore duhet të bëhet në Kuvend, me qëllim të harmonizimit të prioriteteve strategjike të vendit si pushtet i tretë i vendit.

Buxheti i sistemit prokurorial duhet të jetë i qëndrueshëm, gjithëpërfshirës, i menaxhuar përmes sistemeve të avancuara dhe procedurave standarde të kontrollit dhe mbikëqyrjes së menaxhimit të buxhetit dhe financave duke përfshirë edhe te hyrat nga Këshilli dhe donatorët.

**10. Trajtimi i rasteve të bartura**

Raportet e fundit të punës së prokurorive tregojnë se shkalla e kryerjes së lëndëve është më e lartë sesa numri i lëndëve që pranohen çdo vit. Ky është tregues i efikasitetit të lartë të punës së prokurorive. Megjithatë, ende ekziston një numër relativisht i lartë i lëndëve që barten nga viti në vit, gjë që ndryshon pasqyrën reale të punës së prokurorisë, ngaqë nuk është e mundshme të trajtohen të gjithë përnjëherësh.

Për të zbutur këtë situatë do të bëhet një vlerësim i gjendjes së të gjitha rasteve të grumbulluara që tashmë ekzistojnë në prokurori dhe do të ndërmerren masa, do të hartohen politika dhe strategji, në përputhje me rekomandimet, të cilat do të dalin nga ky vlerësim dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Sidoqoftë, KPK-ja do të ndërmarrë edhe disa masa të tjera, që kryesisht kanë të bëjnë më transferime të përkohshme dhe të përhershme të prokurorëve në prokuroritë ku vlerësohet se ka më shumë nevojë, si dhe do të rrisë stafin mbështetës, bashkëpunëtorët profesionalë dhe zyrtarët ligjorë.

Fokusi do të jetë edhe te rritja e efikasitetit në hetimin e rasteve me prioritet, siç është përcaktuar në dokumentet strategjike të sistemit prokurorial.

**II. Shtylla II: Fuqizimi i kapaciteteve institucionale dhe profesionale përmes përmirësimit të integritetit, llogaridhënies dhe transparencës të sistemit prokurorial**

Sistemi i rekrutimit të prokurorëve, vlerësimit të performancës, avancimit dhe zhvillimit të karrierës, procesi i disiplinimit dhe ngritja e kapaciteteve profesionale brenda sistemit prokurorial janë çështje mjaft komplekse që kërkojnë një qasje të kujdesshme dhe të gjithanshme.
Procesi i rekrutimit të prokurorëve është i rregulluar me ligj dhe akte nënligjore të miratuara nga Këshilli.

Kriteret ligjore për emërimin e prokurorëve janë të qarta, kurse procedurat e zhvilluara nga Këshilli sigurojnë një proces të hapur, konkurrues, të barabartë për të gjithë, profesional dhe, mbi të gjitha, ofron garanci për rekrutim të kandidatëve me integritet. Sidoqoftë, zbatimi i këtij sistemi në praktikë ka treguar se ka vend për ndryshim të legjislacionit, në funksion të ngritjes së efikasitetet të procedurave rekrutuese, si dhe ofrimin e mundësive më të mëdha dhe motivimin e juristëve të arsimuar mirë dhe me përvojë në fushën ligjore për t'u bërë pjesë e sistemit prokurorial.

Këshilli është i vetëdijshëm për nevojën e rritjes së besimit të publikut në punën e sistemit prokurorial. Nivelit aktual të besimit të publikut i kanë kontribuar edhe faktorë të jashtëm si procesi i reformave, nëpër të cilat ka kaluar vendi si dhe faktorë të brendshëm që kanë të bëjnë me ndërtimin dhe konsolidimin e strukturës organizative, funksionalizimin e mekanizmave operativë, plotësimin me numrin e nevojshëm të prokurorëve si dhe perceptimin e publikut për praktikat e korrupsionit. Me tejkalimin e kësaj faze, sistemi prokurorial do të përqendrohet në përmirësimin e integritetit, llogaridhënies dhe transparencës së tij përmes ndërmarrjes së masave specifike që janë të detajizuara në objektiva specifike dhe plan të veprimit të këtij plani.

Në anën tjetër, vlerësimi i performancës së prokurorëve dhe zhvillimi i karrierës janë shtyllat kryesore, në të cilat mbështetet zhvillimi i sistemit prokurorial profesional dhe me integritet të lartë. Avancimi i sistemit për vlerësimin e performancës së prokurorëve dhe sistemit të zhvillimit të karrierës nëpërmjet transferimit dhe avancimit të prokurorëve duhet të rishikohen në përputhje me ndryshimet legjislative dhe politikat menaxhuese të sistemit prokurorial, duke respektuar parimet themelore të pavarësisë së punës së prokurorëve dhe parimeve themelore për funksionimin e sistemit prokurorial.

Efikasiteti i punës së sistemit dhe integriteti i tij kanë ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e besimit të publikut për funksionimin e rendit dhe ligjit. Reformimi i procesit të disiplinimit është bërë me Ligjin për përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, prandaj kjo kërkon edhe reforma të brendshme në kuadër të sistemit prokurorial, të cilat do të reflektohen në nxjerrjen e akteve nënligjore, krijimin e mekanizmave të nevojshëm dhe rishikimin e Kodit të etikës.

Ngritja e kapaciteteve profesionale dhe shkathtësive praktike të prokurorëve dhe personelit që reflekton aplikimin e praktikave më të mira dhe konsistente në zbatimin e detyrave të punës me cilësi të lartë, do të jetë objektiva të pashmangshme gjatë tre vjetëve të ardhshëm.

Rishikimi i sistemit aktual të arsimimit ligjor që është në kompetencë të Këshillit dhe prokurorive do të bëhet kryesisht në trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm, me fokus në zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe ndërdisiplinore, veçanërisht për rastet ku vlerësimi i performancës ka tregues jo të mirë për punën e prokurorëve.

**Objektivat specifike**

**1. Fuqizimi i integritetit të prokurorëve**

Një sistem prokurorial me integritet të padiskutueshëm është esencial për sigurimin pajtueshmërisë me demokracinë dhe shtetin ligjor dhe standardi kryesor për besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Kontrolli i vazhdueshëm i integritetit duhet zhvilluar sikurse në çdo sistem demokratik për t'u siguruar në rritjen e besimit të publikut në sistem dhe ruajtjen e integritetit si tërësi.

Pavarësia e sistemit shkon baras me ruajtjen e integritetit dhe llogaridhënien, prandaj për këtë duhet ndërtuar sisteme të fuqishme, të cilat sigurojnë një kontroll të vazhdueshëm të integritetit të prokurorëve.

Gjatë periudhës kohore që përfshin plani strategjik, Këshilli do të forcojë integritetin, llogaridhënien dhe transparencën e sistemit prokurorial, përmes Kodit të ri të etikës bazuar në parimet e Bangalores, udhëzuesit për zbatimin e tij dhe themelimit të mekanizmit këshillëdhënës.

Këshilli do të përdorë praktikat më të mira vendore dhe ndërkombëtare për të zhvilluar modelet ekzistuese dhe të reja të integritetit, llogaridhënies dhe transparencës, të cilat marrin parasysh kërkesat e kuadrove ekzistuese ligjore dhe kushtetuese.

Me arritjen e këtij objektivi do të rrisim transparencën dhe cilësinë e vendimmarrjes së prokurorëve dhe besimin e publikut në sistemin prokurorial.

**2. Avancimi i sistemit për vlerësimin e performancës së prokurorëve**

Vlerësimi i performancës së prokurorëve bëhet në bazë të kritereve objektive dhe të matshme, i cili do të fokusohet në kriteret e integritetit, cilësore dhe sasiore, kurse pesha e secilit kriter për vlerësim do të përcaktohet me akt nënligjor.

Këshilli dhe Prokurori i Shtetit, duke u mbështetur në parimet e lartëpërmenduara, do të analizojnë sistemin aktual të vlerësimit të performancës së prokurorëve dhe do të shqyrtojnë mundësitë e reformimit të tij nga perspektiva e kompetencave të tyre, me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe llogaridhënies së sistemit prokurorial.

Synimi ynë është fuqizimi i sistemit të vazhdueshëm të vlerësimit të performancës, duke u bazuar në vlerësimin periodik të punës, siç përcaktohet me ligj dhe akte të miratuara nga Këshilli, përfshirë edhe fuqizimin e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale për zbatimin e këtij procesi.

**3. Fuqizimi i mëtejmë i sistemit të rekrutimit të prokurorëve**

Sistemi prokurorial, përmes planifikimit të duhur, kërkesave të argumentuara për buxhet shtesë, mobilizim të të gjitha segmenteve të Këshillit, ka mundësuar që të kemi procese të rekrutimit profesionale dhe të bazuara në meritokraci, të cilat janë vlerësuar lart nga institucionet ndërkombëtare gjatë monitorimit. Si rezultat, sot, kemi njëmbëdhjetë (11) prokurorë për njëqindmijë (100.000) banorë, numër ky, që, sipas statistikave të CEPEJ-së, konsiderohet mesatarja e numrit të prokurorëve në Evropë.

Megjithatë, edhe përkundër këtij progresi të matshëm, avancimi i mëtejmë i procesit të rekrutimit është tejet i rëndësishëm, me synimin që të ofrohen mundësi për juristët e rinj me potencial për të ardhmen e sistemit prokurorial, e, në të njëjtën kohë, të inkuadrohen edhe juristë të formuar dhe me përvojë, që do të ishin vlerë e shtuar dhe me ndikim të menjëhershëm në punë.

Andaj, që të mund të rekrutohen këto dy kategori, sistemi i rekrutimit duhet të reformohet.

Në këtë kontekst, rekrutimi i prokurorëve duhet të mbetet kompetencë e Këshillit Prokurorial dhe trupave funksionale të tij. Kjo mundëson dhe garanton rekrutimin e bazuar në meritokraci dhe limiton rrezikun për ndikime politike.

Rekrutimi bëhet në bazë të Kushtetutës, ligjeve në fuqi dhe duke u bazuar në kritere objektive të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore, që i zhvillon Këshilli, përfshirë dhe rekomandimet që dalin nga praktikat më të mira në procesin e rekrutimit të prokurorëve.

Pra, përfshirja në sistem e prokurorëve të rinj, përmes procedurave të rekrutimit, duhet të fokusohet para së gjithash në integritetin e prokurorëve të rinj.

**4. Avancimi i sistemit të zhvillimit të karrierës**

Transferimet e prokurorëve në vitet e fundit nga një prokurori në tjetrën, përkatësisht, nga një departament në tjetrin janë parë si një instrument i rëndësishëm dhe i nevojshëm për funksionimin e duhur të Prokurorit të Shtetit. Megjithatë, baza ligjore ka penguar në një masë të konsiderueshme përdorimin më efektiv të këtij instrumenti.

Në këtë mënyrë, Këshilli synon që të qartësojë këtë dhe parasheh që transferimi i prokurorëve të mund të bëhet në mënyrë vullnetare me kërkesë të prokurorit apo shpallje nga ana e KPK-së. Në rastin e parë, transferimi mund të bëhet vetëm pas kërkesës së prokurorit dhe nëse Këshilli vlerëson se ka vend të lirë për prokurorin në prokurorinë që kërkon transferim, edhe pse një kërkesë e tillë nuk e detyron Këshillin.

Në rastin e dytë, transferimi mund të bëhet për shkak të vlerësimit të nevojave të shfaqura në prokurori të caktuara dhe përmes shpalljes publike që bën Këshilli, me ç'rast të gjithë prokurorët e interesuar mund të aplikojnë. Është e rëndësishme që periudha e transferimit të jetë e mjaftueshme, në mënyrë që të mundësojë arritjen e qëllimit të transferimit.

Po ashtu, transferimi mund të bëhet në mënyrë të detyrueshme si masë disiplinore sipas procedurave të përcaktuara me ligj.

Avancimi prokurorëve duhet të bëhet nga Këshilli përmes një procesi të aplikimit të hapur dhe konkurrues, me ç'rast vlerësohet cilësia e kandidatëve në bazë të kritereve dhe procedurave të përcaktuara nga Këshilli.

Çështjet e transferimit dhe avancimit rregullohen me akt të veçantë të miratuar nga Këshilli në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe bazohen në performancën e tyre dhe transferimet vullnetare në ndihmë të prokurorive të tjera.

**5. Reformimi i sistemit të disiplinimit**

Në mënyrë që sistemi prokurorial të ketë besimin e publikut është jetike që prokurorët dhe personeli mbështetës të jenë profesionalë dhe të respektojnë normat etike, si dhe të zbatojnë mandatin ligjor në mënyrë të pavarur dhe të paanshme ndaj të gjithë shkelësve të ligjit pa dallim.

Gjithashtu, në mënyrë që të sigurohet se këto parime respektohen krahas vlerësimit të performancës dhe trajnimeve është i domosdoshëm edhe funksionimi i mekanizmit të disiplinimit të prokurorëve. Përkundrejt asaj që në vitet e fundit disiplinimi i prokurorëve kryhet në kohë nga Komisioni përkatës i Këshillit, është tejet e nevojshme që sistemi i disiplinimit të avancohet më tutje. Kjo përkon edhe me frymën e ndryshimeve ligjore, të cilat kanë ndodhur sa i përket sistemit të disiplinimit të prokurorëve.

Megjithatë, disiplinimi i prokurorëve është përgjegjësi e Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit sipas një sistemi që mundëson dyshkallshmërinë për vendosjen përfundimtare, përfshirë të drejtën e ankimimit.

Disiplinimi i prokurorëve bëhet sipas ligjit ku procedura mund të fillohet nga autoriteti i përcaktuar me ligj, ndërsa zhvillohet nga paneli i themeluar nga Këshilli. Vendimi lidhur me disiplinimin merret nga Këshilli dhe mund të apelohet në Gjykatën Supreme.

Për zbatimin e legjislacionit lidhur me përgjegjësitë disiplinore të prokurorëve, Këshilli do të nxjerrë aktet nënligjore përkatëse për zbatmin e sistemit të ri të disiplinimit të prokurorëve.

**6. Ngritja e kapaciteteve profesionale dhe shkathtësive praktike të prokurorëve dhe personelit që reflekton aplikimin e praktikave më të mira dhe konsistente në zbatimin e detyrave me cilësi të lartë**

Zhvillimi i kapaciteteve profesionale dhe shkathtësive praktike është e drejtë dhe obligim për secilin prokuror dhe garantohet me ligj. Rëndësia e trajnimit të prokurorëve është e njohur në instrumente ndërkombëtare, si në: Parimet Themelore të OKB-së për Pavarësinë e Gjyqësorit, të miratuara në vitin 1985, ashtu edhe tekstet e Këshillit të Evropës, të miratuara në vitin 1994 (Rekomandimi nr. R (94) 12 për pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve), në vitin 1998 (Karta Evropiane për Statutin e Gjyqtarëve), e cila ishte referuar paragrafit 11 të Opinionit nr. 1 të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (KKGJE).

Programet trajnuese duhet të hartohen në koordinim me Këshillin apo nën ndonjë autoritet tjetër përgjegjës për fillim dhe shërbim të trajnimeve dhe nga trajnuesit apo vetë prokurorët, duke bazuar në politikat e Këshillit.

Në frymën e këtyre akteve janë edhe rekomandimet dhe opinionet e Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë (CCPE). Roli i Kryeprokurorëve për hartimin e programeve trajnuese do të fuqizohet edhe më tej.

Këshilli mbështet Akademinë e Drejtësisë dhe IKAP-in, si autoritete përgjegjës për zhvillimin dhe cilësinë e programeve trajnuese.

KPK-ja në vazhdimësi do të përditësojë dhe informojë prokurorët lidhur me amandamentimin e ligjeve dhe për ligjet e reja të miratuara që kanë ndikim në punën e prokurorëve, me qëllim që të sigurohet zbatimi i drejtë i legjislacionit dhe të rritet cilësia e punës së prokurorëve.

Këshilli përcakton normën orientuese obligative për trajnimin e vazhdueshëm të prokurorëve. Trajnimi do të jetë obligativ në rast të performancës jo të mirë. Kjo synohet me qëllim të rritjes së efikasitetit të punës së sistemit prokurorial dhe rritjes së besimit të publikut.

Andaj, për arritjen e këtyre qëllimeve, Këshilli do të angazhohet në avancimin e proceseve të përcaktimit të politikave, vlerësimit të nevojave, hartimit të programeve trajnuese, të bazuara në zhvillim të kompetencave profesionale dhe interdisiplinare, mundësi të barabarta të pjesëmarrjes në trajnime për të gjithë prokurorët dhe që kjo pjesëmarrje të jetë mbështetje për zhvillimin e karrierës profesionale. Këshilli harton politikat e trajnimit në baza vjetore dhe gjatë vlerësimit të nevojave për trajnime do të merret parasysh edhe vlerësimi i performancës.

**III. Shtylla III: Hetim dhe ndjekje të kryesve të veprave penale që reflekton profesionalizëm, përkushtim, efikasitet dhe respektim të plotë të lirive dhe të drejtave të njeriut përmes zbatimit të standardeve më të larta profesionale dhe etike**

Në periudhën 2016 – 2018, institucioni i Prokurorit të Shtetit është konsoliduar dhe ka shënuar përparim në të gjitha segmentet e funksionimit të tij. Në këtë aspekt, krahas rritjes së numrit të prokurorëve, në vazhdimësi janë zgjidhur më shumë raste sesa janë pranuar, përfshirë dhe rritjen e numrit të lëndëve të zgjidhura prej më shumë se 20 % në secilin vit. Krahas kësaj është rritur edhe përqindja e vendimeve fajësuese për nivelin themelor, duke arritur nga 68% në 91% në vitin 2018.

Megjithatë, mbetet ende shumë punë për t'u bërë në forcimin e besimit të publikut në sistemin prokurorial dhe përpjekje të shtuara për fuqizimin e shtetit ligjor dhe aplikimin e plotë të parimeve fundamentale të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

Në këtë aspekt, Prokurori i Shtetit do të ketë qasje konsistente dhe të pakompromis në ndjekjen penale të të gjithë kryesve të veprave penale pa dallim brenda juridiksionit të tij.

Këmbëngulja në monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit dhe përmirësimit të veprimeve prokuroriale, të cilat përcaktojnë fushëveprimin e aktiviteteve të Prokurorit të Shtetit dhe vendosmërinë për të ndërtuar bashkëpunim efikas me institucionet e sundimit të ligjit dhe institucionet e tjera, me qellim të përmirësimit të mëtejmë të nivelit të ekspertizave dhe unifikimit të praktikave të punës së Prokurorit të Shtetit.

Sistemi prokurorial do të promovojë dhe nxitë prokurorët dhe personelin tjetër administrativ për përdorimin e arritjeve të reja teknologjike në operacionet e Prokurorit të Shtetit, veçanërisht në drejtim të instalimit të sistemeve të reja për përpunimin e automatizuar dhe menaxhimin e rasteve dhe përdorimin e teknologjive të TI-së.

Efikasiteti në punë do të rritet edhe me përdorimin e shtuar të procedurave alternative dhe zbatimit efektiv të sekuestrimit dhe konfiskimit, që mundësojnë, në njërën anë, goditjen më efektive ndaj kryesve të veprave penale dhe, në anën tjetër, promovojnë drejtësinë restorative respektivisht kthimin e mjeteve të fituara me vepër penale në të mirë të shoqërisë.

**Objektivat specifike**

**1. Bashkëpunim me institucionet e sundimit të ligjit në rritjen e cilësisë së kallëzimeve penale dhe të hetimeve efektive**

Prokurori i Shtetit do të ketë qasje të përmirësimit të vazhdueshëm dhe thjeshtësimit të procedurave që t'i mundësojë të gjitha subjekteve kallëzimin e kryesve të veprave penale, duke siguruar trajtim të barabartë dhe gatishmëri në trajtimin e shpejtë dhe profesional të tyre.

Për më tepër, ne do të përmirësojmë cilësinë e punës në çdo fazë përmes shpërndarjes së proceseve sipas standardeve të përcaktuara të cilësisë, duke siguruar që rastet janë të përgatitura mirë dhe në respektim të plotë të lirive dhe të drejtave të njeriut.

Në këtë kontekst, ne do të luajmë rolin tonë në rritjen e cilësisë së kallëzimeve penale, duke përcaktuar standarde dhe praktika të mira përmes trajnimeve dhe tryezave të përbashkëta me përfaqësues të policisë dhe institucioneve të tjera të sundimit të ligjit. Do të formohen grupe punuese dhe do të mbahen takime të rregullta me policinë ku do të prezantohen analiza të detajuara dhe të thukëta për kallëzimet penale dhe evidentimin e sfidave të paraqitura.

Këshilli dhe Prokurori i Shtetit do të propozojnë trajnime të bazuara në praktikat më të mira për rritjen e efikasitetit të hetimeve dhe do të hartojnë procedura dhe udhëzues për të udhëhequr hetimet me kompetencë dhe profesionalizëm të lartë. Në veçanti do të punohet me institucionet e specializuara për zhvillimin e hetimeve të veçanta financiare në rastet e ndryshme penale, duke synuar që ky lloj hetimi të jetë pjesë e përhershme e çdo rasti penal aty ku është i aplikueshëm.

**2. Bashkëpunimi me institucionet përkatëse për kryerjen e ekspertizave në kohë**

Suksesi i ndjekjes penale varet shumë edhe nga cilësia dhe sigurimi në kohë të arsyeshme i ekspertizave. Prokurori i Shtetit në vazhdimësi ka pasur një buxhet të pamjaftueshëm për ekspertiza të ndryshme, duke u bërë një barrë e rëndë për funksionimin e institucionit. Shpesh ekspertizat zgjatin shumë në kohë, gjë që shkakton vonesa në trajtimin e rasteve nga prokurorët. Jo rrallë ndodh që ekspertizat nuk mund të bëhen në vend dhe kërkohet të dërgohen në institute të specializuara jashtë vendit, andaj kjo ka kosto të papërballueshme për buxhetin e sistemit prokurorial dhe humbet kohë e gjatë në marrjen e rezultateve, përfshirë edhe barrierat gjuhësore në nxjerrjen e këtyre ekspertizave. Andaj është tejet e rëndësishme të fuqizohen kapacitetet njerëzore për të siguruar suksesin dhe trajtimin e rasteve me efikasitet brenda sistemit prokurorial në vlerësimin e nivelit të ekspertizave të ndryshme. Në këtë drejtim, sistemi prokurorial do të luajë rol proaktiv dhe ofrojë gjithë kapacitetet profesionale në përcaktimin e kapaciteteve të nevojshme për këto lloj ekspertizash përfshirë hartimin e akteve dhe udhëzuesve. Për më tepër, do të kërkohet që sistemi prokurorial të ketë ekspertë të lëmive jojuridike, të cilët do të mundësonin ofrimin e këshillave profesionale për prokurorët në trajtimin sidomos të rasteve pastrimit të parave, krimeve kibernetike dhe fushave të tjera.

### 3. Konsolidimi i Sistemit për Menaxhimin Iformativ të Lëndëve (SMIL)

Këshilli, përmes Projektit TIK/SMIL ka zhvilluar Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) për të gjitha instancat e Prokurorit të Shtetit dhe tashmë është në fazën e vënies në zbatim të tij. Nga janari 2019 në të gjitha prokuroritë do të fillojë faza e konsolidimit të SMIL-it, me synimin e qartë që gjatë vitit të jetë tërësisht funksional dhe në zbatim në tërë sistemin prokurorial, si dhe do të realizohet ndërlidhja e SMIL-it të prokurorisë me SMIL-in e gjykatave, gjë që nënkupton shkëmbimin e të dhënave në mënyrë elektronike dhe ndërlidhjen me sistemin e Policisë së Kosovës. Po ashtu do të bëhet regjistrimi i të gjitha lëndëve të pakryera në punë në SMIL, por për të arritur këtë është i nevojshëm sigurimi i resurseve humane, të cilat do të bëjnë regjistrimin dhe skanimin e lëndëve në SMIL për një periudhë të caktuar kohore.

SMIL-i është si një sistem i ri, i cili është ndërtuar në bazë të legjislacionit pozitiv dhe nevojave reale të kohës të sistemit prokurorial. Për objektivitet në rastin e ndarjes së lëndëve dhe efikasitetin në zgjidhjen e tyre është e nevojshme të avancohet më tutje, duke u bazuar në kërkesat e përdoruesve dhe në funksion të plotësimit të tij, andaj do të përkrahet ky sistem në avancimin e tij dhe ofrimin e trajnimeve për të gjithë prokurorët dhe personelin që kanë nevojë. Për më tepër, do të synohet ndërlidhja me databaza të tipit të hapur dhe të mbyllur që lehtësojnë punën e prokurorëve në hetim dhe ndjekje.

### 4. Unifikimi i praktikave të punës brenda Prokurorit të Shtetit

Shteti ligjor dhe besimi i publikut në të fuqizohet atëherë kur puna e prokurorëve reflekton profesionalizëm, paanësi dhe efikasitet, si dhe kur për raste të ngjashme ka një qasje uniforme të prokurorëve, në mënyrë që shoqëria të krijojë bindjen e parashikueshmërisë së ndjekjes së kryesve të veprave penale në mënyrë të njëjtë.

Vëmendja dhe përqendrimi real në këtë aspekt institucional dhe në këtë fazë të zhvillimit është i natyrshëm dhe domsodoshmëri, ngaqë në shumë raporte të publikuara monitoruese është kritikuar sistemi prokurorial për jouniformitet në trajtimin e rasteve të natyrës së ngjashme dhe është vlerësuar si një institucion i pakonsoliduar, i cili ka nevojë për ngritjen e kapaciteteve profesionale.

Padyshim, kjo situatë ka ardhur si rezultat i shumë faktorëve, siç ishin sfidat në legjislacion si rezultat i reformave dhe ndryshimeve të shpeshta, gjë që nuk ka arritur të krijojë praktika të konsoliduara për prokurorët vendorë dhe ndërkombëtarë, të cilët do të punonin me kompetencë në trajtimin e rasteve penale dhe kanë ardhur nga sisteme të ndryshme gjyqësore, pastaj numri i vogël i prokurorëve dhe personelit administrativ, mungesa e buxhetit, etj.

Tashmë, sistemi prokurorial ka arritur në një fazë të konsoliduar të zhvillimit, duke krijuar edhe praktika të zbatimit të legjislacionit dhe me një numër të konsoliduar të prokurorëve dhe personelit mbështetës. Prokurori i Shtetit do të fokusohet në fuqizimin e profesionalizmit dhe monitorimit sistematik të trajtimit të rasteve.

Në këtë drejtim do të formohen mekanizma që do të monitorojnë punën e prokurorëve, hartojnë udhëzime për zbatimin praktik të legjislacionit bazuar në jurisprudencën vendore dhe instrumentet ndërkombëtare, si dhe ofrojnë konsulencë përmes tryezave të punës dhe forumeve të krijuara në platformën online (Intranet).

**5. Zbatimi efektiv i procedurave të sekuestrimit dhe konfiskimit**

Sistemi prokurorial ka bërë përpjekje të vazhdueshme për rritjen e sekuestrimit të pasurisë me vepër penale, me qëllim të kthimit të mjeteve në dobi të shoqërisë. Përfitimi në mënyrë të kundërligjshme është jetik për veprimtarinë e krimit të organizuar, ngase këto përfitime riinvestohen në aktivitete të tjera kriminale. Duke sekuestruar dhe konfiskuar pasurinë e fituar me vepër penale ndërpritet cikli që i mban këto organizata kriminale në ushtrimin e aktiviteteve të tyre të kundërligjshme. Duke i prioretizuar sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve, në veçanti të krimit të organizuar dhe krimeve ekonomike, synohet rritja e performancës në rimarrjen dhe përdorimin e aseteve të fituara në mënyrë të kundërligjshme në funksion të mbrojtjes së shoqërisë nga dëmi i shkaktuar.

Ne synojmë të përmirësojmë cilësinë e kësaj pune, duke përfshirë vendimmarrjen e prokurorëve gjatë gjithë fazave të një rasti.

Ne do ta bëjmë këtë duke i siguruar të gjithë prokurorëve mjetet dhe aftësitë e duhura për punën që ata bëjnë dhe bazuar në standardet ndërkombëtare të përcaktuara. Ne do të fuqizojmë mekanizmat ekzistues me qëllim të një shkëmbimi të informatave në kohë të shpejtë dhe ndërmarrjen e veprimeve të integruara nga të gjithë institucionet përkatëse vendore. Për më tepër, synohet që të fuqizohet bashkëpunimi ndërkombëtar në këto fusha. Në këtë drejtim do të hartohen procedura standarde të veprimit që do të përcaktojnë praktika të njëjta dhe konsistente për të gjitha aspektet e ngrirjes, sekuestrimit, konfiskimit dhe përdorimit të këtyre aseteve.

Këshilli dhe ZKPSH-ja do të rrisin monitorimin e zbatimit të legjislacionit, udhëzuesve dhe politikave të miratuara për këtë qellim.

**6. Zbatimi efektiv i procedurave alternative për zgjidhjen e rasteve**

Prokurori i Shtetit ka përvetësuar qasjen e përdorimit të procedurave alternative në zgjidhjen e rasteve, duke e vlerësuar si një mjet të duhur për zvogëlimin e lëndëve të vjetra, rritjen e efikasitetit në zgjidhjen e rasteve me kosto më të ulët dhe në funksion të drejtësisë restorative.

Në këtë aspekt, Prokurori i Shtetit për vite me radhë promovon përdorimin e procedurave alternative, duke matur performancën e prokurorive në numrin e rasteve të zgjidhura me këto procedura në raport me numrin e rasteve të zgjidhura në tërësi. Synimi ishte që të zgjidhen të paktën 10% e rasteve me procedura alternative dhe ky synim është arritur siç shihet nga raportet e dy vjetëve të fundit.

Procedurat alternative do të vazhdojnë të përdoren edhe në të ardhmen si një mjet shumë i rëndësishëm në dispozicion të prokurorëve, andaj Prokurori i Shtetit synon që përmes mekanizmave të krijuar të hartojë udhëzues dhe politika, si dhe të ofrojë udhëzime përmes tryezave të punës dhe trajnimeve dhe të monitorojë aplikimin e tyre në praktikë.

### 7. Fuqizimi i mbrojtjes së viktimave të krimit

Prokurori i Shtetit do të vazhdojë qasjen e përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimit ndaj viktimave të krimit, duke siguruar një sistem që ofron ndihmën e duhur në procesin e vënies së drejtësisë për viktimat. Përmes kësaj qasjeje synohet që viktimat e krimit të ndihen të sigurta dhe të flasin me personelin adekuat të sistemit prokurorial për dëmin dhe vuajtjet e tyre të shkaktuara, si dhe të jenë të sigurt që do të dëgjohen dhe mbështeten përgjatë këtij procesi pa marrë parasysh rrethanat apo nivelet e tyre.

Në këtë drejtim do të përmirësojmë programet trajnuese për prokurorë dhe mbrojtësit e viktimave dhe do të sigurojmë udhëzuesit përkatës për intervistimin, mbledhjen e dëshmive, përgatitjen e tyre për dhënien sa më të mirë të dëshmive dhe mbështetjen e tyre gjatë procesit gjyqësor.

## IV. Shtylla IV: Prioretizimi i hetimit të veprave penale dhe ndjekjes së kryesve të krimit të organizuar, korrupsionit, krimeve ekonomike, pastrimit të parave, krimeve të luftës, terrorizmit dhe krimit kibernetik, dhunës në familje dhe krimeve të urrejtjes

Roli dhe rëndësia e Prokurorit të Shtetit, për garantimin e sundimit të rendit dhe ligjit si në çdo shoqëri, edhe në Kosovë është mjaftë i rëndësishëm. Kjo rëndësi shtohet veçanërisht kur bëhet fjalë për luftimin e formave më specifike të kriminalitetit.

Sistemi prokurorial i Kosovës do të zhvilloj sistemin e prioritizimit të formave më të veçanta të krimeve dhe do të krijoj dhe fuqizoj mekanizmat ekzistues për rritjen e efikasitetit në luftimin e tyre në mënyrë shumë më të fuqishme.

Vëmendje të posaçme do të marrë lufta ndaj krimeve të luftës dhe terrorizmit, përmes rritjes dhe forcimit të kapaciteteve të resurseve për trajtimin e rasteve të reja dhe atyre të pranuara nga EULEX-i, lufta kundër krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parave, krimeve ekonomike, trafikimi me qenie njerëzore dhe krimi kibernetik, duke rishikuar strukturën organizative aktuale të prokurorive dhe analizuar sistemin e punës, rritur numrin e prokurorëve

dhe stafit mbështetës në bazë të nevojave, ngritjes së kapaciteteve profesionale, infrastrukturës së nevojshme ligjore dhe mbikëqyrjes së proceseve të punës. Pjesë e këtyre prioriteteve do të jetë edhe trajtimi i rasteve të dhunës në familje dhe krimeve të urrejtjes, por jo vetëm.

Këshilli dhe ZKPSH në mënyrë të vazhdueshme do të vlerësojnë nevojat e sistemit duke mbikëqyrur punën e prokurorive dhe do të zbatojnë strategji e përcaktojnë politika me qëllim të trajtimit dhe luftimit të këtyre, por edhe formave tjera specifike të kriminalitetit të cilat i kërcënojnë vlerat demokratike të vendit dhe të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

**Objektivat specifike**

**1. Fuqizimi i performancës së prokurorëve në luftimin e krimeve të luftës dhe terrorizmit**

Krimet e luftës dhe terrorizmi kanë qenë në kompetencë ekskluzive të administratës së Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë - UNMIK) dhe Misionit të BE-së, EULEX, deri në vitin 2016. Nga kjo periudhë ka filluar transferimi i këtyre lëndëve te prokurorët e Kosovës dhe është shënuar një dinamikë e re në trajtimin e tyre. Progres evident dhe i vlerësuar nga partnerët ndërkombëtarë është shënuar sidomos në trajtimin e rasteve të terrorizmit. Megjithatë përderisa trajtimi i rasteve të luftës përkundër që ka shënuar progres ballafaqohet me sfida në proces të transferimit të rasteve të lëndeve dhe informacioneve të plota nga EULEX-i. Për trajtimin e rasteve të krimeve të luftës, PSRK-ja ka themeluar një departament të veçantë dhe gjatë vitit 2018 e ka përforcuar këtë me prokurorë shtesë. Kjo pritet të shtojë dinamikën e trajtimit të këtyre rasteve, megjithatë, PSRK-ja në bashkëpunim me ZKPSH-në dhe KPK-në tashmë kanë në proces të vlerësimit draftin e Strategjisë për Krime të Luftës, si një dokument i rëndësishëm strategjik për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës dhe krimeve të tjera të rënda, të përcaktuara sipas të drejtës ndërkombëtare në nivel kombëtar, e cila adreson prioritetet e PRSK-së, PSH-së dhe KPK-së.

PSH-ja dhe KPK-ja do të punojnë që PSRK-ja t'i përcaktojë prioritetet dhe kriteret për shqyrtimin e lëndëve të krimeve të luftës dhe, në këtë kontekst

synohet që të forcohet struktura e saj përmes profilizimit të prokurorëve, adresimit të nevojave për ngritje të kapaciteteve profesionale, numrit të nevojshëm të prokurorëve dhe personelit, fuqizimit të bashkëpunimit me institucione vendore dhe ndërkombëtare në mbledhjen dhe shkëmbimin e informatave dhe provave për trajtimin e rasteve në kompetencë të kësaj prokurorie.

**2. Rritje e efikasitetit në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parave, krimeve ekonomike, trafikimi me qenie njerëzore dhe krimi kibernetik**

Aktivitetet e ndryshme kriminale që cenojnë rendin juridik në Kosovë janë nga më të ndryshmet. Format më të shprehura të kriminalitetit, në të cilat do të përqendrohet sistemi prokurorial gjatë tre vjetëve të ardhshme, por pa u kufizuar vetëm në to, janë krimi i organizuar, korrupsioni, pastrimi i parave, krimet ekonomike, trafikimi i qenieve njerëzore dhe krimi kibernetik.

Rishikimi i strukturës organizative aktuale të prokurorive dhe një analizë e pengesave në punën e prokurorive për rritjen e efikasitetit në trajtimin e këtyre rasteve do të jenë veprimet e para që do të realizohen, në drejtim të rritjes së rezultateve të punës.

Në funksion të rritjes së efikasitetit në luftën kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik, Këshilli do të vazhdojë të mbështesë Njësitin për luftimin e Krimit Ekonomik dhe Korupsionit në Prokurorinë Themelore të Prishtinës përmes sigurimit të kushteve adekuate për punë. Me qellim të monitorimit të rezultateve të punës, Këshilli do të formojë një Komision Mbikqyrës i cili do të raportojë në baza të rregullta dhe do të bëjë rekomandime.

Plotësimi i PSRK-së me numrin e nevojshëm të prokurorëve dhe departamenteve përkatëse të prokurorive, duke u bazuar në numrin e rasteve në trajtim, qoftë përmes emërimeve të reja dhe transferimeve, krijimit të kushteve adekuate për punë, rritjes së numrit të bashkëpunëtorëve profesionalë dhe zyrtarëve ligjorë, organizimit të tryezave të punës ndërmjet prokurorëve dhe hetuesve, ngritjes së kapaciteteve profesionale, nxjerrjes së akteve normative, rritjes së shkallës së monitorimit dhe raportimit, janë disa nga pikat strategjike të Këshillit për luftimin e këtyre fenomeneve kriminale.

Në mbështetje të kësaj do të bëhen hulumtime, hartohen dokumente strategjike dhe rekomandime të nevojshme te të gjitha autoritetet përkatëse. E, kjo do të shoqërohet me mbështetjen e duhur buxhetore dhe me infrastrukturë nga ana e Këshillit.

Nëpërmjet këtyre masave synohet që të rritet numri i rasteve të proceduara kundër krimit të organizuar, krimit ekonomik, korrupsionit të nivelit të lartë, trafikimit të njerëzve, numrit të ankesave dhe mjeteve të jashtëzakonshme juridike dhe numrit të vendimeve për ngrirje dhe sekuestrim të aseteve të fituara me vepër penale.

**3. Qasje proaktive në trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe krimeve të urrejtjes**

Numri i rasteve të dhunës në familje është shqetësues edhe për sistemin prokurorial. Deri më tani janë ndërtuar të gjithë mekanizmat dhe infrastruktura e nevojshme për luftimin e këtij fenomeni. Një prej çështjeve më të rëndësishme në këto raste vlerësohet të jetë koha e reagimit të autoriteteve kompetente, veçanërisht e Prokurorit të Shtetit, si dhe trajtimi i kryesve dhe viktimave të këtyre rasteve. Kompleksiteti dhe ndjeshmëria e rasteve vështirësojnë trajtimin e tyre, prandaj synojmë që të mbështesim profilizimin e prokurorëve dhe avancimin profesional për trajtim të këtyre rasteve, ku në secilën prokurori do të ketë prokuror të specializuar për trajtimin dhe procedimin e këtyre rasteve. Theks të veçantë do të ketë edhe fuqizimi i zyrtarëve për mbrojtje të viktimave dhe rritja e numrit të tyre për të plotësuar nevojat në secilin rajon. Këshilli do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të rritur efikasitetin për procedimin e rasteve dhe për të evituar në secilin rast dështimin për të ofruar mbrojtje të viktimave të dhunës në familje.

Ngjashëm do të veprohet edhe me rastet e krimeve të urrejtjes, për të cilat deri më tani ka një numër relativisht të vogël të rasteve. Këto raste do të trajtohen nga prokurorë të profilizuar, të cilëve do t'iu ofrohet të gjitha kushtet dhe do të mbështeten në zhvillimin e kapaciteteve profesionale.

## V. Sigurimi i buxhetit për zbatimin e Planit strategjik

Objektivat e përcaktura në këtë plan pasqyrojnë qartë nevojat e sistemit prokurorial në përmbushje të misionit kushtetues dhe ligjor, si dhe në arritjen e synimit të dëshiruar, i cili është përcaktuar në vizionin e tij.

Gjatë hartimit të këtij plani, krahas fokusit në përcaktimin e objektivave specifike, të matshme dhe veprimeve të definuara qartë për arritjen e tyre, një vëmendje e veçantë iu ka kushtuar edhe kapaciteteve buxhetore të nevojshme për realizimin e sukseshëm të tyre.

Zbatimi i këtij plani strategjik kërkon një planifikim të mirë buxhetor veçanërisht për financimin e projekteve të reja dhe funksionalizimin e mekanizmave të rinj të paraparë me këtë plan. Buxheti i sistemit prokurorial ka shënuar rritje të konsiderueshme viteve të fundit në të gjitha kategoritë buxhetore,dhe ka përmbushur nevojat kryesore të sistemit në përgjithësi. Megjithatë, ky plan strategjik ka rritur në masë relativisht të lartë nevojën për buxhet shtesë për të përmbushur masat e reja që synohet të realizohen gjatë këtyre tre vjetëve.

Në përmbushje të objektivave dhe aktiviteteve të këtij plani do të hartohen edhe dokumentet financiare si: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH), buxheti vjetor dhe planifikimi për tre vjetët e ardhshëm, me qëllim që të reflektohen obligimet që dalin nga ky plan strategjik. Në të njëjtën kohë do të bëhet edhe rishikimi i planifikimeve buxhetore për linja dhe kode të caktuara buxhetore, duke racionalizuar buxhetin në përshtatje të planit strategjik.

Gjithsesi, mbështetja e ardhur nga Ambasada e SHBA-së për proceset kryesore, propozimprojektet aktuale në kuadër të IPA-s, Projekti i Mbretërisë së Bashkuar për mbështetje të sistemit prokurorial, projektet e Qeverisë së Norvegjisë dhe të Holandës, janë të orientuara fuqishëm në vlerësimin e shumë proceseve të punës, që janë të përcaktuara si objektiva në këtë plan dhe paraqesin garancë se ky plan do të realizohet mbështetur edhe në përkrahjen profesionale dhe financiare të partnerëve ndërkombëtarë.

## VI . Monitorimi i zbatimit të Planit Strategjik

Strategjia është dokument i gjallë që duhet të zbatohet dhe të monitorohet, andaj për monitorimin e zbatimit të Planit Strategjik, Këshilli do të krijojë grup të veçantë për të raportuar për zbatimin e objektivave strategjike, duke u bazuar në planin e monitorimit për zbatimin e strategjisë.

Raportimi për rezultatet e arritura dhe rekomandimet do të bëhet në baza periodike tremujore, si dhe do të hartohen raportet përmbledhëse vjetore, duke u mbështetur në planin e monitorimit, i cili duhet të përmbajë së paku këto kritere raportimi:

- Periudhën e raportimit;
- Llojin e të dhënave që do të mblidhen, kur, si dhe kush është përgjegjës;
- Vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së të dhënave;
- Numrin e objektivave, aktiviteteve dhe veprimeve të monitoruara;
- Shkallën në përqindje të përmbushjes së objektivave të monitoruar;
- Arsyet e mospërmbushjes së objektivave të caktuara;
- Rreziqet e identifikuara në moszbatimin e objektivave strategjike dhe
- Rekomandimet për shmangien e rreziqeve për periudhën e ardhshme.

## VII. Përfundim

Zhvillimi i sistemit prokurorial të pavarur, të paanshëm, profesional dhe efikas është i një rëndësie të madhe për Këshillin Prokurorial.

Paanshmëria, integriteti dhe standardi i lartë i hetimit dhe i ndjekjes së kryesve të dyshuar të veprave penale nga ana e prokurorive janë qenësore për sundimin e ligjit, për çka Këshilli dhe të gjitha dikasteret e tij do të angazhohen maksimalisht për arritjen e objektivave të përcaktuara dhe ngritjes së rezultateve të punës në secilin segment të sistemit prokurorial.

Plani strategjik 2019-2021 është në funksion të përmbushjes së kritereve, vlerave dhe standardeve më të larta të bashkëkohore të punës në sistemin prokurorial.

Me këtë rast dëshirojmë të shprehim falënderimin tonë të veçantë për të gjithë ata që kanë kontribuar në hartimin e Planit strategjik dhe ata që do të përfshihen dhe mbështesin zbatimin e tij.

## VIII. Plani i veprimit

| Shtylla | Objektiva specifike | Aktiviteti | Përgjegjësit | Afati kohor | Financimi | Treguesit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Shtylla I: Fuqizimi i efikasitetit dhe efektivitetit të administrimit të sistemit prokurorial** | 1.1. Fuqizimi i kornizës ligjore dhe strukturës organizative të sistemit prokurorial | Platforma në procesin e rishikimit funksional dhe Agjenda e Përbashkët "Drejtësia 2020", me fokus në fuqizimin e rolit në hartimin e legjislacionit | Këshilli dhe Prokurori i Shtetit | Qershor 2019 | | Platforma e hartuar |
| | | Themelimi i një mekanizmi për përfshirje në hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të legjislacionit | Këshilli | Qershor 2019 | | |
| | | Hartimi i menaxhimit të proceseve legjislative (në përfaqësim) nga komisionet e sistemit të prokurorial | Këshilli ZKPSH-ja | Dhjetor 2020 | | Udhëzim administrativ për menaxhimin e proceseve i hartuar |
| | | Rishikimi i strukturës organizative të administratës së sistemit prokurorial | Këshilli & Prokurori i Shtetit | Dhjetor 2020 | | Aktet nënligjore të hartuara |
| | | Propozimi për angazhim me punë të përhershme të anëtarëve prokurorë në Këshill | Këshilli | Dhjetor 2019 | | Propozim dokumenti i hartuar |
| | | Miratimi i Rregullores për organizimin e brendshëm dhe funksionimin e Prokurorit të Shtetit | Këshilli Komisioni për Çështje Normative Sekretariati | Janar – dhjetor 2019 | | Rregullorja e miratuar |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Plotësim-ndryshimi i Rregullores për transferimin dhe avancimin e prokurorëve | Këshilli Komisioni për Çështje Normative Sekretariati NJSHPP | Janar – dhjetor 2019 | | Rregullorja e miratuar |
| | | Plotësim-ndryshimi i Rregullores për vlerësimin e performancës së prokurorëve | Këshilli Komisioni për Çështje Normative Sekretariati NJSHPP-ja | Prill – dhjetor 2019 | | Rregullorja e miratuar |
| | | Hartimi i akteve normative për zbatimin e Ligjit për përgjegjësinë deisiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve | Këshilli Komisioni për Çështje Normative Sekretariati | Janar-qershor 2019 | | Rregullorja |
| | | Hartimi i akteve normative për zbatimin e Ligjit për ndërmjetësimin | Këshilli Komisioni për Çështje Normative Sekretariati | Janar-qershor 2019 | | Rregullorja |
| | | Hartimi i Rregullores për NJSHPP-në | Këshilli Komisioni për Çështje Normative Sekretariati NJSHPP-në | Janar – dhjetor 2019 | | Rregullorja |
| | | Hartimi i udhëzimit për dosje të prokurorëve | Këshilli Komisioni për Çështje Normative | Janar – dhjetor 2019 | | Udhëzuesi |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Sekretariati NJSHPP-ja | | | |
| | | Plotësimi-ndryshimi i Rregullores për Këshillin Prokurorial të Kosovës | Këshilli Komisioni për Çështje Normative Sekretariati | Janar – dhjetor 2019 | | Rregullorja |
| | | Hartimi i Rregullores për arkivim dhe dokumentim | Këshilli Komisioni për Çështje Normative Sekretariati | Janar – dhjetor 2019 | | Vendimi për themelimin e Grupit punues Rregullorja |
| | | Hartimi i Rregullores për shërbimin e komunikimit publik të sistemit prokurorial | Këshilli Komisioni për Çështje Normative Sekretariati NJSHPP-ja | Janar – dhjetor 2019 | | Rregullorja |
| | | | | | | |
| | | Udhëzimi për përcaktimin e angazhimit të interpretëve ose përkthyesve normës së prokurorëve | Këshilli Komisioni për Çështje Normative Sekretariati | Janar – dhjetor 2019 | | Udhëzimi i miratuar |
| | | Hartimi i Rregullores për zhvillimin profesional të prokurorëve dhe personelit administrativ | Këshilli Komisioni për Çështje Normative Sekretariati NJSHPP-ja | Janar – dhjetor 2019 | | Rregullorja e miratuar |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Udhëzimet për trajnimin e prokurorëve për vitin 2019 dhe 2020 | Këshilli Sekretariati NJSHPP | Tetor – dhjetor 2019 | | Plani i trajnimeve |
| | | Themelimi i mekanizmit për hartim të rekomandimeve për legjislacion | Këshilli PSH-ja | Mars – qershor 2019 | | Vendimi |
| | | Propozimi për mandatin e përhershëm në Këshill të anëtarëve prokurorë të Këshillit | Këshilli PSH-ja | Janar – dhjetor 2019 | | Propozimi |
| | | Hartimi i Strategjisë për trajtimin me prioritet të korrupsionit dhe krimit ekonomik 2019 -2021 | Këshilli Grupi punues i themeluar nga Këshilli PSH-ja Sekretariati NJSHPP-ja | Janar – qershor 2019 | Vendime t e Këshillit | Strategjia e miratuar |
| | | Miratimi i Strategjisë për trajtimin e krimeve të luftës 2019-2021 | Grupi punues i themeluar nga Këshilli PSH Sekretariati NJSHPP-ja | Janar – mars 2019 | Vendime t e Këshillit | Strategjia e miratuar |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | 1.2. Avancimi i statusit dhe rolit të prokurorëve dhe stafit administrativ | Formimi i një mekanizmi që trajton rastet e denigrimit të | Këshilli | Dhjetor 2021 | | Mekanizmi i formuar |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | personalitetit të prokurorëve | | | | |
| | | Përcaktimi i procedurës për themelimin e njësive të specializuara në kuadër të prokurorive | Këshilli | Dhjetor 2021 | | Akti nënligjor i hartuar |
| | | Ndërmarrja e hapave për ofrimin e sigurimeve shëndetësore për prokurorë dhe personelin administrativ | Këshilli | Dhjetor 2021 | | Raportet<br>Rekomandimet<br>Propozimet |
| | | Reformim i sistemit të sigurisë personale të prokurorëve | Këshilli | Dhjetor 2019 | | Udhëzimi për sigurinë personale i miratuar |
| | | Reformim i sistemit të sigurisë së objekteve prokuroriale | Këshilli | Dhjetor 2019 | | Udhëzimi për sigurinë e objekteve i miratuar<br>Plan i sigurisë |
| | | Angazhimi në procesin e hartimit të ligjeve për administratën publike | Këshilli | Mars 2019 | | Rekomandimet për projektligjet të hartuara |
| | | Rregullimi i procesit të rekrutimit, klasifikimit, transferimit, vlerësimit avancimi etj., të shërbyesve civil brenda sistemit prokurorial | | Qershor 2020 | | Aktet nënligjore të miratuara |
| | | Angazhimi në procesin e mbrojtjes së statusit të avancuar të shërbyesve civil | Këshilli<br>PSH-ja | Shkurt – dhjetor 2019 | | Propozimet e shkruara<br>Takimet me institucionet relevante |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1.3. Llogaridhënia sistematike dhe kontrolli permanent i punës së prokurorëve | Krijimi i sistemit të kontrollit permanent të verifikimit | Këshilli | Dhjetor 2021 | | Analizë Rregullores e miratuar Personeli i përgatitur për kryerjen e punës |
| | | Krijimi i mundësive për këshilldhënie për çështje etike për prokurorë | Këshilli dhe Prokurori i Shtetit | Dhjetor 2019 | | Propozim dokument për ndryshime ligjore |
| | | Krijimi i mekanizmit për vlerësimin e hudhjeve të kallëzimeve penale | Këshilli dhe Prokurori i Shtetit | Mars 2020 | | Akti nënligjor i miratuar |
| | | Krijimi i mekanizmit për monitorimin *ex officio* të përhershëm të integritetit dhe sjelljeve etike | Këshilli | Qershor 2020 | | Propozim dokumenti i miratuar |
| | | Vlerësim dhe hartim i analizës në funksion të llogaridhënies dhe integritetit | Këshilli PSH-ja | Janar – dhjetor 2020 | | Analiza e hartuar |
| | | Përcaktimi i sistemit të ri të mbikëqyrjes së punës së prokurorëve dhe prokurorive, vlerësimit të integritetit dhe rritjes së llogaridhënies | Këshilli PSH-ja | Janar – dhjetor 2020 | | Analiza e hartuar |
| | | Aktivitete informuese dhe udhëzuese për zbatimin e Kodit të Etikes | Këshilli PSH-ja | Janar – qershor 2019 | | Kampanja e përfunduar |
| | | Përfshirja e raportit të Komisionit për hudhjet, | Këshilli PSH-ja | Shtator – dhjetor 2019 | | Akti normativ Procedura e re e vlerësimit |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | në vlerësimin e performances | | | | |
| | | Ndërmarrja e masave adekuate individuale lidhur me hudhjet | Këshilli PSH-ja | 2019-2021 | | Masat e zbatuara |
| | | Raportimi i kryeprokurorëve | Kryeprokurorët e prokurorive Këshilli | 2019-2021 | Raportet Procesverbalet | |
| | | Raportimet e Komisioneve të përhershme dhe ad hoc | Këshilli Komisionet e përhershme të Këshillit | 2019-2021 | - Raportet - Procesverbalet | |
| | | | | | | |
| | 1.4. Transparenca dhe komunikimi publik | Qasje në një portal unik të sistemit prokurorial | Këshilli PSH-ja | Dhjetor 2021 | | Portali online |
| | | Zhvillimi i Intranetit | Këshilli PSH-ja | Shtator 2020 | | Intraneti funksional |
| | | Takime të rregullta me qytetarë dhe media – zhvillimi i planit për takime | Këshilli dhe Prokurori i Shtetit | 2019-2021 | | Takimet e realizuara |
| | | Kampanja informuese – zhvillimi i planit për kampanja | Këshilli dhe Prokurori i Shtetit | 2019-2021 | | Kampanjat e realizuara |
| | | Publikim në kohë reale i statistikave të lëndëve | Këshilli | 2019-2021 | | Statistikat e publikuara |
| | | Hartim i manualit për komunikim me publikun | Këshilli dhe Prokurori i Shtetit | Shtator 2019 | | Manuali i publikuar |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Rishikimi i Strategjisë për komunikim publik | Këshilli | Qershor 2019 | | Strategjia e rishikuar e miratuar |
| | | Standardizimi dhe unifikimi i informacionit të brendshëm dhe të jashtëm | Këshilli | Shtator 2019 | | Dokumentet standarde të krijuara |
| | | Rishikimi i Strategjisë për komunikim | Këshilli | Nëntor 2019 | | Strategjia e rishikuar |
| | | Hartimi i udhëzuesit për procedura standarde të veprimit për komunikim efektiv | Këshilli | Qershor 2020 | | Udhëzuesi i hartuar |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | 1.5. Sigurimi i infrastrukturës fizike adekuate | Zhvillimi i procesit për vlerësim të nevojave për kushte të përshtatshme pune në të gjitha prokuroritë, KPK dhe njësitë vartëse | SKPK-ja | Mars 2019 | | Procesi i vlerësimit të nevojave i përfunduar |
| | | Hapësira adekuate përfshirë infrastrukturën përcjellëse për KPK dhe ZKPSH, PSRK-në dhe vlerësim të nevojave për prokuroritë tjera | Këshilli | Qershor 2020 | | Kërkesa buxhetore, Plani ideor për hapësira të nevojshme për KPK dhe të gjitha prokuroritë i hartuar |
| | | Pajisja e Këshillit dhe prokurorive me inventar | Këshilli | Qershor 2021 | | Këshilli dhe prokuroritë të pajisura me |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | inventarin e nevojshëm |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | 1.6. Bashkëpunimi me institucionet vendore mbështetur në respekt reciprok | Marrëveshje bashkëpunimi me KGJK, Ministrinë e Drejtësisë, Akademinë e Drejtësisë, Policinë dhe institucione tjera të zbatimit të ligjit | Këshilli dhe Prokurori i Shtetit | Mars 2020 | | Marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara |
| | | Tryeza diskutimi dhe takime të ndryshme me sektorin jo qeveritar | Këshilli dhe Prokurori i Shtetit | 2019-2021 | | Tryezat<br>Raportet<br>Rekomandimet |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | 1.7. Bashkëpunimi me partnerë dhe donatorë (bashkëpunimi ndërkombëtarë) | Takime koordinuese me donatorë | Këshilli dhe Prokurori i Shtetit | 2019-2021 | | Takimet e realizuara |
| | | Marrëveshje me institucione dhe forume të cilat ushtrojnë mandat të njëjtë | Këshilli dhe Prokurori i Shtetit | 2019-2021 | | Marrëveshjet e arritura |
| | | Përcaktimi i prioriteteve për procesin e integrimeve evropiane | Këshilli dhe Prokurori i Shtetit | 2019-2021 | | Prioritetet e përcaktuara |
| | | Krijimi i një mekanizmit koordinues/ ndërlidhës | Këshilli | Qershor 2019 | | Mekanizmi funksional |
| | | Vlerësimi i nevojave për mbështetje nga donatorët | Këshilli dhe SKPK | 2019-2021 | | Nevojat e përcaktuara |
| | | Vlerësimi i rezultateve të arritura nga projektet e kaluara | Këshilli dhe Prokurori i Shtetit | 2019-2021 | | Raportet<br>Rekomandimet |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Pjesëmarrja aktive në forume koordinuese me donatorë në nivel vendi | Këshilli dhe Prokurori i Shtetit | 2019-2021 | | Agjendat Raportet |
| | | Vazhdimi i zbatimit të projekteve aktuale | Këshilli Prokurori i Shtetit SKPK | 2019-2021 | | Raportet Rekomandimet |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | 1.8 Teknologjia informative dhe menaxhimi i të dhënave | Teknologji informative adekuate për digjitalizim të proceseve të punës | Këshilli | Qershor 2020 | | Teknologjia e nevojshme e blerë dh e instaluar |
| | | Ndërtim i një sistemi standard të arkivave (fizik, elektronik) në Prokurorin e Shtetit | Këshilli | Shtator 2021 | | Sistemi funksional |
| | | Hartimi i programeve të trajnimit dhe organizimi i trajnimeve | Këshilli SKPK-ja | 2019- 2021 | | Tryezat dhe kampanja e realizuar |
| | | Funksionalizimi i data bazës për dosjet elektronike të prokurorëve | Këshilli Prokurori i Shtetit NJSHPP-ja | Mars 2019 | | Data baza në aplikim |
| | | Zbatimi i sistemit elektronik të aplikimit për prokurorë të rinj | Këshilli PSH-ja SKPK-ja NJSHPP-ja | 2019-2021 | | Data baza në aplikim |
| | | Aplikimi i plotë i SIMBNJ-së | Këshilli PSH-ja NJSHPP-ja | 2019-2021 | | Data baza në aplikim |
| | | Zhvillimi dhe aplikimi i data bazave të brendshme për | Këshilli Prokurori i Shtetit | 2019- 2020 | | Data bazat e zhvilluara dhe në aplikim |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | menaxhimin e proceseve të punës në sistemin prokurorial | SKPK-ja | | | |
| | | | | | | |
| | 1.9 Avancimi i rolit institucional në proceset buxhetore dhe financiare | Konsultime për planifikim buxhetor me prokurori | Këshilli dhe Prokurori i Shtetit | 2019- 2021 | | Konsultimet për buxhet të realizuara |
| | | Planifikim buxhetor i bazuar në nevoja dhe orientime strategjike | Këshilli dhe Prokurori i Shtetit | 2019- 2021 | | Buxheti i hartuar |
| | | Avancimi i procesit të mbikëqyrjes dhe kontrollit | Këshilli | 2019-2021 | | Procesi i avancuar |
| | | Angazhimi dhe kontributi në përcaktimin e pagave barabartë me pushtetet tjera | Këshilli | Janar – mars 2019 | | Takimet Kërkesat Komentet dhe rekomandimet |
| | 1.10 Trajtimi i rasteve të bartura | Vlerësimi dhe analizimi i gjendjes së lëndëve të bartura | Këshilli PSH-ja NJSHPP-ja | Qershor – dhjetor 2019 | | Raporti analitik me rekomandime |
| | | Analizë e lëndëve lidhur me rastet me kryes të panjohur | Këshilli PSH-ja NJSHPP-ja | Qershor – dhjetor 2019 | | Raporti analitik me rekomandime |
| | | Vlerësimi i normës orientuese | Këshilli PSH-ja NJSHPP-ja | Qershor – dhjetor 2019 | | Raporti me rekomandime |
| | | Vlerësimi i trendëve të lëndëve të reja | Këshilli PSH-ja NJSHPP-ja | Qershor – dhjetor 2019 | | Raporti analitik me rekomandime |
| | | Trajtimi i rasteve të parashkruara | Këshilli PSH NJSHPP-ja | Qershor – dhjetor 2019 | | Rastet e parashkruara të vendosura |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Transferimet e prokurorëve sipas nevojave të prokurorive | Këshilli PSH-ja | 2019 | | Raporti analitik me rekomandime |
| | | | | | | |
| **Shtylla II: Fuqizimi i kapaciteteve institucionale dhe profesionale përmes përmirësimit të integritetit, llogaridhënies dhe transparencës të së sistemit prokurorial l** | 2.1 Fuqizimi i integritetit të prokurorëve | Vlerësimi i sistemit aktual për verifikimin e integritetit të prokurorëve | Këshilli PSH-ja | Mars-qershor 2020 | | Raporti rekomandimet |
| | | Forcimi i mekanizmave të kontrollit të integritetit | Këshilli PSH-ja | Qershor – dhjetor 2020 | | Mekanizmat funksional |
| | | Zbatimi i mbikëqyrjes së përhershme të zbatimit të standardeve të integritetit | Këshilli PSH-ja | 2019- 2021 | | Raporti Rekomandimet |
| | | Forcimi i mekanizmave për përfshirjen e publikut në punën e sistemit prokurorial | Këshilli PSH-ja | 2019-2021 | | Raporti Rekomandimet |
| | | Forcimi i mekanizmave të llogaridhënies | Këshilli PSH | 2019-2021 | | Raporti Rekomandimet |
| | | Rishikimi i Kodit të Etikës | Këshilli | Dhjetor 2019 | | Kodi i etikes i ndryshuar |
| | | | | | | |
| | 2.2 Avancimi i sistemit për vlerësimin e performances së prokurorëve | Hartimi i koncept dokumentit për sistemin e vlerësimit të prokurorëve | Këshilli PSH-ja | 2019-2021 | | Koncept dokumenti |
| | | Rishikimi i kritereve të vlerësimit | Këshilli PSH-ja | 2019-2021 | | Kriteret e rishikuara |
| | | Hartimi i rekomandimeve për ndryshimet ligjore të nevojshme | Këshilli PSH-ja | 2019-2021 | | Raporti me rekomandime |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Forcimi i lidhjes së vlerësimit vjetor me vlerësimin 3 vjeçar | Këshilli PSH-ja | 2019-2021 | | Sistemi i zhvilluar |
| | | | | | | |
| | 2.3 Fuqizimi i mëtejmë i sistemit të rekrutimit | Rishikimi i procesit të rekrutimit | Këshilli | Shtator 2019 | | Koncepti dokumenti i hartuar |
| | | Propozim/rekomandimet për ndryshime legjislative | Këshilli dhe Prokurori i Shtetit | Dhjetor 2019 | | Propozimet e hartuara |
| | | Rishikimi i akteve nënligjore | Këshilli | Qershor 2020 | | Aktet nënligjore të ndryshuara/plotësuara |
| | | Avancimi i mekanizmave për rekrutim të prokurorëve | Këshilli | Dhjetor 2020 | | Mekanizmat e brendshëm të zhvilluar në përputhje me ndryshimet ligjore |
| | | Avancimi i kritereve të vlerësimit gjatë provimit / rekrutimit | Këshilli | Dhjetor 2020 | | Kriteret e hartuara |
| | | Analiza afatgjatë e nevojave për rekrutimin e prokurorëve | Këshilli<br>ZKPSH<br>Sekretariati NJSHPP<br>Kryeprokurorët e prokurorive | Qershor 2020 | | Raporti Dokumenti analitik |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | 2.4 Avancimi i sistemit të zhvillimit të karrierës (fuqizimi i sistemit të | Rishikimi i akteve nënligjore për procedurat | Këshilli dhe Prokurori i Shtetit | Mars 2020 | | Akti nënligjor i miratuar |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | transferimit dhe avancimit të prokurorëve) | e transferimit dhe avancimit | | | | |
| | | Rishikimi i procesit të transferimit | Këshilli | Shtator 2019 | | Koncepti dokumenti i hartuar |
| | | Vlerësimi afatgjatë për transferime dhe avancime | Këshilli dhe Prokurori i Shtetit NJSHPP-ja | Mars 2020 | | Raporti me rekomandime |
| | | Krijimi i mekanizmave për transferim dhe avancim | Këshilli | Qershor 2020 | | Mekanizmat e zhvilluar (formular, lista etj.._ |
| | | Përcaktimi i kritereve për transferim dhe avancim bazua në rezultatet e punës | Këshilli PSH-ja | Qershor 2020 | | Kriteret e përcaktuara |
| | | | | | | |
| | 2.5 Reformimi i sistemit të disiplinimit | Hartimi i akteve nënligjore për zbatimin e ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve/Prokurorëve | Këshilli dhe Prokurori i Shtetit | Dhjetor 2019 | | Akti nënligjor i miratuar |
| | | Formimi i paneleve hetimore bazuar ne rregulloren përkatëse | Këshilli | 2019-2021 | | Vendimet e Këshillit |
| | | Përgatitjen e paneleve për shqyrtimin e rasteve | Këshilli | 2019-2021 | | Panelet e formuara dhe të trajnuara |
| | | Sistemimi i stafit të ZPD | Këshilli | Janar-mars 2020 | | Stafi i sistemuar në njësitë përkatëse |
| | | Krijimi i regjistrave për dosjet disiplinore | Këshilli SKPK-ja | Janar – mars 2019 | | Regjistrat e krijuar |
| | | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2.6 Ngritja e kapaciteteve profesionale dhe shkathtësive praktike të prokurorëve dhe personelit që reflekton aplikimin e praktikave më të mira dhe konsistente në zbatimin e detyrave me cilësi të lartë | Përcaktimi i politikave të trajnimit (3 vjeçare) | Këshilli dhe Prokurori i Shtetit | Shtator 2019 | | Politikat e miratuara |
| | | Hartimi i aktit nënligjor për ngritje të kapaciteteve | Këshilli dhe Prokurori i Shtetit | Nëntor 2019 | | Akti nënligjor i miratuar |
| | | Ngritja e kapaciteteve të Zyrës për trajnime | Këshilli | Mars 2020 | | Kapacitetet e ndërtuara |
| | | Krijimi i mekanizmave për vlerësimin e nevojave për trajnime | Këshilli | Mars 2020 | | Mekanizmat e krijuar |
| | | Krijimi i mekanizmave për monitorimin e pjesëmarrjes në trajnime dhe matjen e efektit | Këshilli | Dhjetor 2019 | | Mekanizmat e krijuar |
| | | Ndërlidhja e sistemit të rekrutimit, performancës dhe trajnimeve | | | | |
| **Shtylla III: Hetim dhe ndjekje të kryesve të veprave penale nga Prokurori i Shtetit që reflekton profesionalizëm, përkushtim, efikasitet dhe respektim të plotë të lirive dhe të drejtave të njeriut** | 3.1 Bashkëpunim me institucionet e sundimit të ligjit në rritjen e cilësisë së kallëzimeve penale dhe të hetimeve efektive | Takime dhe tryeza me institucionet që paraqesin kallëzime penale për përmirësimin e tyre | Këshilli dhe Prokurori i Shtetit | 2020-2021 | | Tryezat<br>Raportet<br>Rekomandimet |
| | | Propozimet për trajnime për rritje të efikasitetit të hetimeve | Këshilli<br>PSH | 2020-2021 | | Propozimet |
| | | Hartimi i udhëzuesve për udhëheqje të hetimeve | PSH-ja | Shtator 2019 – mars 2020 | | Udhëzuesit e hartuar |
| | 3.2 Bashkëpunimi me institucionet përkatëse për kryerjen e ekspertizave në kohë | Fuqizimi i kapaciteteve njerëzore për vlerësimin e nivelit të ekspertizave | Këshilli<br>PSH | Dhjetor 2021 | | Stafi i trajnuar |
| | | Propozimi për angazhim të ekspertëve të | Këshilli<br>PSH-ja | Dhjetor 2021 | | Stafi i rekrutuar dhe trajnuar |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **përmes zbatimit të standardeve më të larta profesionale dhe etike (përfshirë aplikimin e procedurave alternative, sekuestrimin dhe konfiskimin)** | | përhershëm për fusha të caktuara (pastrimit të parave, krimit kibernetik etj. | | | | |
| | | Zhvillimi i bashkëpunimit me institucionet që ofrojnë ekspertiza | Këshilli PSH-ja | Dhjetor 2021 | | Takimet Marrëveshjet |
| | | | | | | |
| | 3.3 Konsolidimi i Sistemit Elektronik për Menaxhimin e Lëndëve | Konsolidimi dhe implementimi i plotë i TIK/SMIL | Këshilli Sekretariati PSH-ja | Janar – dhjetor 2019 | | - Raportet e monitorimit<br>- SMIL i funksionalizuar |
| | | Instalimi i softuerëve të nevojshëm nëpër të gjitha prokuroritë | Këshilli Sekretariati PSH-ja | Janar – dhjetor | | - Softueri |
| | | Vendimet përkatëse, monitorimi dhe masat për zbatimin e TIK/SMIL | Këshilli Sekretariati | Janar – dhjetor | | - Raportet<br>- Procesverbalet |
| | | Zhvillimi i moduleve të reja dhe përditësimi i atyre ekzistuese në SMIL | Këshilli | 2019-2021 | | Modulet e reja të identifikuara të zhvilluara dhe të përditësuara |
| | | Organizimi i kampanjave informuese për zbatimin e SMIL | Këshilli | Mars-qershor 2019 | | Kampanjat e realizuara |
| | | Hartimi dhe publikimi i udhëzuesve dhe broshurave për zbatimin e SMIL | Këshilli | Mars-qershor 2019 | | Udhëzuesit dhe broshurat e publikuara |
| | | Ngritja e kapaciteteve të stafit për zbatim të SMIL | Këshilli | Mars-dhjetor 2019 | | Trajnimet e organizuara |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Regjistrimi i lëndëve të reja në SMIL | Këshilli dhe Prokurori i Shtetit | 2019-2021 | | Lëndët e reja të regjistruara |
| | | Regjistrimi i lëndëve të vjetra | Këshilli dhe Prokurori i Shtetit | Mars 2019- mars 2020 | | Lëndët e vjetra të regjistruara |
| | | Tryeza dhe fushata informimi për aplikimin e SMIL | Këshilli SKPK-ja | 2019- 2021 | | Tryezat dhe kampanja e realizuar |
| | | Hartimi i udhëzuesve dhe broshurave për zbatimin e SMIL-it | Këshilli SKPK-ja | 2019- 2021 | | Tryezat dhe kampanja e realizuar |
| | | Monitorimi i funksionimit të SMIL | Këshilli SKPK-ja NJSHPP-ja | 2019- 2021 | | Raportet |
| | | | | | | |
| | 3.4 Unifikimi i praktikave të punës brenda Prokurorit të Shtetit | Themelimi i mekanizmave për monitorimin e punës së prokurorëve | Këshilli SKPK-ja NJSHPP-ja | Dhjetor 2020 | | Mekanizmat funksional |
| | | Hartimi i udhëzimeve për unifikimin e proceseve të punës së prokurorëve | Këshilli SKPK NJSHPP | 2019- 2021 | | Udhëzuesit |
| | | Ofrimi i këshillave dhe trajnimeve për zbatim të legjislacionit | Këshilli SKPK-ja NJSHPP-ja | 2019- 2021 | | Raportet |
| | | Forcimi i mekanizmave mbikëqyrës | Këshilli SKPK | Qershor 2021 | | Raportet Rekomandimet |
| | | Krijimi i platformës konsultuese online | Këshilli SKPK-ja | Dhjetor 2021 | | Raportet |
| | | | | | | |
| | | Forcimi i burimeve njerëzore në zbatimin e | Këshilli PSH-ja | 2019-2021 | | Raportet Rekomandimet |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 3.5 Zbatimi efektiv i procedurave të sekuestrimit dhe konfiskimit | legjislacionit ne këtë fushë | SKPK-ja | | | |
| | | Fuqizimi i mekanizmave ekzistues për efikasitet të punës | Këshilli PSH-ja | Mars 2020 | | Mekanizmat plotësisht funksional |
| | | Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtarë | Këshilli PSH-ja | 2019-2021 | | Marrëveshjet Raportet |
| | | Hartimi i procedura standarde të veprimit | Këshilli PSH-ja | 2019-2021 | | Procedurat e hartuara |
| | | Hartimi i udhëzuesve dhe politikave për zbatim të legjislacionit | Këshilli SKPK-ja | 2019-2021 | | Udhëzuesit dhe politikat e hartuara |
| | | Fuqizimi i mekanizmave monitorues | Këshilli PSH-ja SKPK-ja NJSHPP | 2019-2021 | | Raportet Rekomandimet |
| | | | | | | |
| | 3.6 Zbatimi efektiv i procedurave alternative për zgjidhjen e kontesteve | Rritja e numrit të rasteve të aplikimit të procedurave alternative | Këshilli PSH-ja SKPK-ja NJSHPP-ja | 2019-2021 | | Raportet Rekomandimet |
| | | Hartimi i udhëzuesve dhe politikave për zbatim të legjislacionit | Këshilli PSH-ja | Mars 2020 | | Udhëzuesit dhe politikat e hartuara |
| | | Fuqizimi i mekanizmave monitorues | Këshilli PSH-ja SKPK-ja NJSHPP-ja | 2019-2021 | | Raportet Rekomandimet |
| | | Caktimi i referentit për ndërmjetësim në secilën prokurori | Këshilli PSH-ja SKPK-ja | Qershor 2019 | | Zyrtarët e caktuar |
| | | Caktimi i zyrës së veçantë për procedurat e | Këshilli PSH-ja | Qershor 2019 | | Zyra e caktuar |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ndërmjetësimit në prokurori | SKPK-ja | | | |
| | | | | | | |
| | 3.7 Fuqizimi i mbrojtjes së viktimave të krimit | Të krijohet ambient i sigurt dhe i përshtatshëm për viktimat e krimit | Këshilli PSH-ja ZMNV-ja | 2019-2021 | | Ambientet adekuate |
| | | Përmirësimi i programeve të trajnimit për prokurorë dhe mbrojtësit e viktimave | Këshilli PSH-ja ZMNV-ja | Dhjetor 2020 | | Programet e trajnimit të hartuara |
| | | Hartimi i udhëzuesve për intervistim | Këshilli PSH-ja | Mars 2021 | | Udhëzuesit e hartuar |
| | | Hartimi i udhëzuesve për mbledhjen e dëshmive, përgatitjen e viktimave për të dhënë dëshmitë e tyre | Këshilli PSH-ja | Mars 2021 | | Udhëzuesit e hartuar |
| | | | | | | |
| **Shtylla IV: Hetimi dhe ndjekja me prioritet e veprave penale të krimit të organizuar, korrupsionit, krimeve ekonomike, pastrimit të parave, krimeve të luftës dhe terrorizmit si** | 4.1 Fuqizimi i performances së prokurorëve në luftimin e krimeve të luftës dhe terrorizmit | Fuqizimi i Departamentit për Krime Lufte në PSRK | Këshilli ZKPSH-ja PSRK-ja | Mars 2021 | | Departamenti tërësisht funksional |
| | | Zbatimi i strategjisë për trajtimin e rasteve të krimeve të luftës | PSRK-ja | 2019-2021 | | Raportet e monitorimit |
| | | Ngritje e kapaciteteve profesionale | Këshilli PSH-ja PSRK-ja | 2019- 2021 | | Stafi i përgatitur |
| | | Fuqizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar për mbledhje dhe shkëmbim të informatave | Këshilli ZKPSH-ja PSRK-ja | 2019- 2021 | | Marrëveshjet e bashkëpunimit Raportet |
| | | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **dhe krimit kibernetik** | 4.2 Rritje e efikasitetit në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parave, krimeve ekonomike, trafikimi me qenie njerëzore dhe krimi kibernetik | Rishikimi i strukturës organizative të prokurorive për rritje të efikasitetit | Këshilli PSH-ja | Qershor 2019- 2020 | | Struktura e re funksionale |
| | | Hartimi i një analize për identifikimin e pengesave për trajtimin e rasteve | Këshilli PSH-ja | Qershor 2020 | | Analiza e hartuar |
| | | Rritja e numrit të prokurorëve dhe stafit në departamentet përkatëse sipas nevojave | Këshilli PSH-ja | Dhjetor 2020 | | Numri adekuat i prokurorëve dhe stafit |
| | | Ngritja e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe stafit mbështetës | Këshilli PSH-ja | 2019- 2021 | | Stafi i përgatitur |
| | | Hartimin e akteve normative të nevojshme | Këshilli PSH-ja | Shtator 2020 | | Aktet e hartuara |
| | | Rritja e numrit të rasteve (sa %) të ngrirjes dhe konfisikimit | Këshilli PSH-ja | 2019- 2021 | | Numri më i madh i rasteve të ngritjes dhe konfiskimit |
| | | Rritja e nivelit të monitorimit dhe raportimit të rasteve | Këshilli PSH-ja SKPK-ja NJSHPP-ja | 2019- 2021 | | Stafi i përgatitur |
| | 4.3 Qasje proaktive në trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe krimeve të urrejtjes | Profilizimi i prokurorëve në secilën prokurori | Këshilli PSH-ja | 2019- 2021 | | Prokurorët e caktuar |
| | | Ngritja e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe stafit mbështetës | Këshilli PSH-ja | 2019- 2021 | | Stafi i përgatitur |
| | | Fuqizimi i rolit të ZMNV-së | Këshilli ZKPSH-ja ZMNV-ja | 2019- 2021 | | Stafi i përgatitur |
| | | | | | | |